Kamata ndihmon në krijimin e një natyre luksoze pa u angazhuar në asnjë lloj pune. Ajo sjell shtimin e pasurisë pa asnjë mundim dhe përfituesit prej saj kthehen në parazitë, të cilët rriten në kurriz të të tjerëve. Islami e lavdëron dhe e nderon punën dhe punëtorët, duke e konsideruar atë si rrugën më të mirë përfituese, pasi kjo zhvillon aftësitë e njeriut dhe rrit moralin e tij.

Kamata është mjet kolonizimi. Për këtë arsye është thënë: “Kolonizimi vjen pas tregtarëve dhe misionarëve.”

Islami kërkon që njeriu t’i japë vëllait të tij hua me mirësi, nëse ai ka nevojë për para dhe për këtë vepër i njej atij një shpërblim të madh.³⁴ Në të kundërtën, Islami ndalon pasurimin e padrejtë, të paarsyeshëm dhe të përvetësimit të pronës së tjetrit në mënyrë të padrejtë.

Llojet e kamatës:

Llojet e kamatës janë dy:

- Kamata e vonesës (ربا النسيئة)
- Kamata e shtesës (ربا الفضل)

Kamata e vonesës

Kamata e vonesës është shtesa e kushtëzuar që merr borxhdhënësi nga borxhmarrësi në këmbim të vonesës.³⁵ Si p.sh., nëse ndokush merr hua nga dikush, për një kohë të caktuar, për një muaj apo për një vit, duke e kushtëzuar shtesën në mallin e marrë, për shkak të vonesës. Për këtë arsye është quajtur me emrin e vonesës për shkak se shtimi apo teprica i kthehet pas një kohe, gjegjësisht pas një vonese.³⁶ Ky lloj ishte ai që njihej në periudhën e injorancës, kur dikush merrte borxh nga dikush tjetër për ta paguar atë më vonë, por kur afati vinte dhe s’kishte mundësi të paguante, detyrohej të shtonte shumën si dëmshpërblim për shtyrjen.

Kjo lloj kamate është mjaft e njohur në kohën tonë, e në bazë të së cilës veprojnë sistemet bankare, që e quajnë ndryshe si interes, por që në esencë nuk dallon fare nga ai sistem i kohës së injorancës.

Kamata me anë të vonesës është më se e qartë dhe nuk ka nevojë të sqarohet, sepse në të janë të pranishme elementet kryesore të çdo veprimi që lidhet me kamatën dhe që janë shtesa e kuotës së pasurisë dhe kohës së shlyerjes, për të cilën paguhet kjo shtesë dhe gjithashtu konsiderimi i kamatës një kusht i padiskutueshëm në marrëveshje, pa të cilën marrëveshja nuk konsiderohet e saktë, gjë që sjell krijimin e pasurisë nga pasuria me shkak kohën ose afatin.³⁷

³² Muhamed Ali Sabuni, *Fikhul Muamelat*. vëll. I, fq. 160.

³³ Op, cit: vëll.I, fq. 161.

³⁴ Sejid Sabik, *Legjislacioni i traditës së Profetit*, vëll. III, fq. 244.

³⁵ Sejid Sabik, *Legjislacioni i traditës së Profetit*, vëll. III, fq. 245.

³⁶ Muhamed Ali Sabuni, *Fikhul Muamelat*. vëll. I, fq. 141.

³⁷ Muhamed bin Saleh el-Uthejmin, Ahmed Es-Salus, *Kamata, lufta me Allahun*, fq. 36.

Kamata e shtesës

Kamata e shtesës është shitja ose këmbimi i dy mallrave të njëjta me shtesë, apo shitja e monedhave me monedha apo e ushqimit me ushqim, me diferencë në masën e tyre.³⁸ Pra, shtesë, e cila merret kur këto dy mallra këmbehen me njëri-tjetrin.³⁹ Për të qenë më të qartë mund të themi se kamata e shtesës është të shesësh, apo të këmbesh diçka me diçka tjetër të të njëjtit lloj, duke shtuar diçka, siç mund të jetë shitja e arit me ar, dërhemit me dërhëm, grurit me grurë, elbit me elb etj.⁴⁰

Ky lloj është i ndaluar në traditën e Profetit dhe në konsensusin e dijetarëve, sepse vetvetiu përbën një formë që shpie drejt kamatës së vonesës. Këtij veprimi i është dhënë emri kamatë, sepse përmban mundësinë e kamatës.⁴¹

عَنْ عَبْدِ بْنِ الصَّامِتِ قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ الدَّهْبُ بِالدَّهْبِ وَالْفِضَّةُ بِالْفِضَّةِ وَالْبُرُّ بِالْبُرِّ وَالشَّعِيرُ بِالشَّعِيرِ وَالتَّمْرُ بِالتَّمْرِ وَالْمِلْحُ بِالْمِلْحِ مِثْلًا يَمِثِلُ سَوَاءً بِسَوَاءٍ يَدًا يَدًا فَإِذَا اخْتَلَفَتْ هَذِهِ الْأَصْنَافُ فَبِيعُوا كَيْفَ شِئْتُمْ إِذَا كَانَ يَدًا يَدًا

Nga Ubadeh ibn Samit transmetohet se i Dërguari i Allahut [paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të] ka thënë: “Ari me ar, argjendi me argjend, gruri me grurë, elbi me elb, hurma me hurmë, kripa me kripë, njësoj me njësoj, peshë me peshë dhe dorë me dorë, e nëse këto lloje ndryshojnë (nga njëri-tjetri) atëherë shisni si të doni nëse këmbehen dorë me dorë.”⁴²

Nga hadithi kuptohet se ndalohet këmbimi brenda një lloji, siç mund të jetë ari, argjendi, gruri, duke shtuar diçka në masë nga njëri

krah mbi tjetrin, e në anën tjetër lejohet shitja apo këmbimi i arit me ar, argjendit me argjend dhe gjërave të tjera, nëse veprohet pa tepricë në peshë, ashtu siç lejohet të shiten apo këmbehen njëri lloj me tjetrin, si ari me argjend apo gruri me elb, edhe nëse ndryshojnë në masë me kusht nëse këmbimi bëhet dorë me dorë, apo këmbim i menjëherëshëm.

Motivi i ndalimit

Këta gjashtë artikuj, që janë përmendur në hadith, janë artikujt kryesorë për të cilët njeriu ka nevojë e s’mund të bëjë dot pa ta. Floriri dhe argjendi janë elementet kryesore të parasë me të cilat rregullohen marrëdhëniet dhe shkëmbimet. Ato përfaqësojnë standardet e çmimeve të cilat mbështetemi për vlerësimin e mallrave. Ndërsa katër artikujt e tjerë janë elemente të ushqimeve bazë, me të cilat njerëzit mbahen gjallë. Nëse kamata qarkullon në këta artikuj, ajo do të dëmtojte njerëzit dhe do të prishte marrëdhëniet ndërmjet tyre. Kështu, Sheriati e ka ndaluar atë, si mëshirë për njerëzit, si dhe për të ruajtur interesat e tyre.

Llojet që përfshin kamata (interesi)

Dijetarët janë unanimë në pikëpamjen se kamata e shtesës është në gjashtë llojet e cekura, por sa u përket llojeve tjera që nuk janë të cekura në hadithe, ata shfaqin mendime të ndryshme.

Pjesa dërrmuese e dijetarëve janë të mendimit se kamata përfshin edhe llojet tjera⁴³, e jo vetëm ato që i cek hadithi, por ato janë baza e tyre, kurse një pjesë e dijetarëve janë të mendimit se kamata përfshin vetëm llojet e specifikuar në hadithe⁴⁴.

Hanefitë mendojnë se shkaku dhe parametri me të cilin njihen pasuritë përbërëse të kamatës, është që kjo pasuri të jetë e peshueshme

³⁸ Sejid Sabik, *Legjislacioni i traditës së Profetit*, vëll. III, fq. 245.

³⁹ Muhamed bin Saleh el-Uthejmin, Ahmed Es-Salus, *Kamata, lufta me Allahun*, fq. 36.

⁴⁰ Op, cit: fq. 37.

⁴¹ Sejid Sabik, *Legjislacioni i traditës së Profetit*, vëll. III, fq. 245.

⁴² Muslimi në Sahihun e tij, nr. 2970.

⁴³ Hanefitë dhe hanbelitë janë të mendimit se çdo gjë që matet e peshohet, mund të rrjedh në të interesit (kamata), që nënkupton se përfshin edhe llojet tjera. Ndërsa, sipas Shafiut dhe një mendimi tjetër të Ahmedit, interesi mund të jetë në vlera monetare apo në ushqim, qoftë të jenë edhe jo të matura e as të peshuara.

⁴⁴ Mendim i Dhahirive.

apo e matshme me masë dhe që të jenë mallra të të njëjtit lloj. Sipas mendimit të tyre, kamata i tejkalon gjashtë llojet dhe përmbledh çdo gjë që peshohet apo matet me masë dhe që është i të njëjtit lloj me mallin që këmbehet, qofshin këto mallra vlera monetare apo ushqime.⁴⁵ Ndërsa në pasuritë (mallrat) tjera sipas vlerës, si shtazët, shtëpitë, toka, pemët (trungjet) e drunjtë etj.,⁴⁶ aty nuk ka interes (kamatë), e në to, - sipas hanefive - lejohet ndërrimi i të shumtës me të paktën, sikurse ndërrimi i një shtaze me dy, ngase vlerat e tyre nuk mund të maten.⁴⁷

Në pamje të parë, duket e vështirë të kuptohet se përse për këdo që dëshiron të këmbejë një sasi të caktuar ari ose argjendi, ose çdo artikull tjetër kundrejt të njëjtit artikull, ato duhet të jenë të barabarta dhe aty për aty. Ajo që është thelbësore dhe që kërkohet është drejtësia dhe veprimi i ndershëm në transaksionet e menjëhershme; çmimi dhe kundërvlera duhet të jenë të drejta në të gjitha transaksionet, ku bëhet pagesa kesh (pavarësisht çfarë e përbën paranë) nga njëra palë dhe artikulli ose shërbimi jepet reciprokisht nga pala tjetër. Çdo gjë që merret si 'ekstra' nga njëra nga dy grupet e transaksionit është riba el-fadl-kamatë e shtesës, që do të mund të përkufizohet me fjalët e Ibn El-Arabiut si "çdo tejkalim mbi atë që është e arsyeshme nga kundërvlera". Drejtësia mund të arrihet vetëm atëherë nëse dy shkallët e peshores mbartin të njëjtën vlerë të mallit. Kjo pikë është shpjeguar në mënyrën më të përshtatshme nga i Dërguari Muhamed [paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të], kur ai iu referua gjashtë artikujve të rëndësishëm dhe theksoi që nëse një shkallë ka një nga "këta artikuj, shkalla tjetër po ashtu duhet të ketë artikullin e njëjtë", "i njëjti për të njëjtin dhe i barabarti për të barabartin". Për të siguruar drejtësinë, i Dërguari (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të), dekurajoi madje edhe shkëmbimin e transaksioneve dhe kërkoi që artikulli për shitje të këmbehet me paranë kesh dhe ai të përdoret për blerjen e

artikullit të nevojshëm. Kjo ndodh për shkak se nuk është e mundur në një transaksion shkëmbyes, përveç për një ekspert, që të shihet ekuivalenti i drejtë i një artikulli karshi mallrave të tjera. Prandaj, ekuivalentët mund të krijohen vetëm përafërsisht, duke çuar kështu në disa padrejtësi për njërin ose grupin tjetër. Prandaj, përdorimi i parasë mund të ndihmojë në uljen e mundësisë për një këmbim të padrejtë.⁴⁸

ALTERNATIVAT

Islami e pranon rolin legjitim të sektorit privat. Megjithatë, meqë prona private në Islam është një gjë e besuar nga Zoti, pronari nuk ka të drejtë absolute mbi të. Superioriteti i vlerave morale, imperativi i drejtësisë shoqërore-kulturore dhe qëllimi i paprekshëm për mirëqenie të përgjithshme shoqërore imponon një sërë përmbajtjesh mbi pronën private. Prandaj, do të ishte e natyrshme dhe e dëshirueshme për shtetin islam të luante një rol konstruktiv dhe të orientuar drejt mirëqenies dhe madje të vinte nën kontroll dhe nën menaxhim të shtetit çdo gjë që e konsideron të domosdoshme në interes më të madh të publikut. Sidoqoftë, kjo nuk do të thotë të argumentohet në favor të totalitarizmit ose të një shkalle të lartë të organizimit ushtarak, pasi ka një fushë të konsiderueshme për liri individuale në Islam brenda kornizave të vlerave dhe qëllimeve islame.

Islami nuk e shpërfill rolin e kapitalit si faktor prodhimi. Megjithatë, duke qenë se kthimi në kapital mund të përcaktohet vetëm pasi të gjitha kostot të jenë llogaritur, dhe mund të jetë pozitiv ose negativ, Islami e ndalon një shkallë pozitive të paracaktuar të kthimit në formë interesi. Islami kërkon hisen në fitim dhe në humbje, në një mënyrë të barabartë, ashtu që financuesi të ketë hise si në humbje edhe në fitim, sipas proporcionit të kapitalit të tij në biznes, nëse dëshiron të ketë hise në fitim.⁴⁹

Islami, si alternativë ndaj kamatës, ka paraparë forma të ndryshme, si huaja e mirë që njihet si *kard hasen*, financimi i drejtë dhe

⁴⁵ Muhamed bin Saleh el-Uthejmin, Ahmed Es-Salus, *Kamata, lufta me Allahun*, fq. 39.

⁴⁶ Zerka', *El-Med'hal ila Nadhrjeti-l Iltizam*, fq. 139.

⁴⁷ Vehebeh Zuhejli, *el-Fikhul Islamij ve Edil-letuhu*, vëll. V, fq. 3707.

⁴⁸ Grup autorësh, *Hyrje në ekonominë dhe financat islame*. fq. 61.

⁴⁹ Grup autorësh, *Hyrje në ekonominë dhe financat islame*. fq. 65-66.

partneriteti që përfshin dy format e njohura të financimit në jurisprudencën islame: *Mudarebeh* dhe *sherikeh*.⁵⁰

KARD HASEN-HUAJA PA PËRFITIM

Kard hasen është një hua, e cila kthehet në fund të kohës për të cilën është arritur marrëveshja pa asnjë interes ose hise në fitim ose humbje të biznesit.

Borxhi konsiderohet vepër e pëlqyer (*mustehab*) për dhënësin apo borxhdhënësin, bazuar në fjalët e të Madhërishmit⁵¹:

مَنْ ذَا الَّذِي يُقْرِضُ اللَّهَ قَرْضًا حَسَنًا فَيُضْعِفُهُ لَهُ وَأَلَّا أَجْرُ كَرِيمٍ

“Kush është ai që i huazon Allahut një hua të mirë e që Ai t’ia shu-mëfishojë atë dhe ai ka një shpërblim të mirë.”⁵²

Borxhdhënia është mënyrë afrimi tek Allahu i Lartësuar, sepse në të shprehet dhembshuria për njerëzit dhe mëshira për ta, si dhe lehtësi-mi i punëve dhe i vështirësive që ata kanë. Duke qenë se Islami e ka pëlqyer dhënien e borxhit, ai, gjithashtu, ia ka lejuar nevojtarit të kërkojë borxh dhe nuk e ka konsideruar atë pjesë të kërkesës së pa-pëlqyer, pasi ai e merr këtë pasuri që të përfitojë prej saj, për të kryer nevojat e veta, e më pas t’ia kthejë atë kujt i takon.⁵³

Në një hadith thuhet:

عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ مَنْ نَفَسَ عَنْ مُسْلِمٍ كُرْبَةً مِنْ كُرْبِ الدُّنْيَا نَفَسَ اللَّهُ عَنْهُ كُرْبَةً مِنْ كُرْبِ يَوْمِ الْقِيَامَةِ وَمَنْ يَسَّرَ عَلَى مُعْسِرٍ فِي الدُّنْيَا يَسَّرَ اللَّهُ عَلَيْهِ فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ وَمَنْ سَتَرَ عَلَى مُسْلِمٍ فِي الدُّنْيَا سَتَرَ اللَّهُ عَلَيْهِ فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ وَاللَّهُ فِي عَوْنِ الْعَبْدِ مَا كَانَ الْعَبْدُ فِي عَوْنِ أَحِيهِ

⁵⁰ M.A. Mannan, Monzer Kahf, Ausaf Ahmad, *International economic relations from Islamic perspectives*, Jeddah, Saudi Arabia, 1412h/1992, fq. 144.

⁵¹ Ebu Beker el-Xhezairi, *Minhaxhul Muslim*, fq. 281.

⁵² Kur’ani, Hadid: 11.

⁵³ Sejid Sabik, *Legjislacioni i traditës së Profetit*, vëll. III, fq. 249.

Nga Ebu Hurejre transmetohet se i Dërguari i Allahut [paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të] ka thënë: “Kush ia lehtëson një myslimani një brengë nga brengat e kësaj jete, Allahu do t’ia lehtësojë atij një brengë prej brengave të Ditës së Kiametit. Kush ia lehtëson barrën një nevojtarit në këtë botë, Allahu do t’ia lehtësojë atij në Dynja dhe Ahiret, e kush ia fsheh një të metë një myslimani në këtë botë, Allahu do t’ia fshehë atij në Dynja dhe Ahiret. Allahu është çdoherë në ndihmën e robit, derisa rob i jetë në ndihmën e vëllait të tij.”⁵⁴

Përderisa për dhënësin e borxhit është vepër e pëlqyer, për borxh-marrësin është vepër e lejuar, ngase jeta shpesh ia imponon edhe atë gjatë nevojave dhe vështirësive.⁵⁵

Pritja dhe afatizimi i borxhit⁵⁶

Është mirë që të pritët borxhliu sipas mundësive të tij, e, nëse kërkon afatizim, t’i mundësohet atij, ngase pa dyshim që për këtë ka shpërblim për borxhdhënësin. Për këtë porositi i Madhërishmi kur thotë:

وَإِنْ كَانَ ذُو عُسْرَةٍ فَنَظِرَةٌ إِلَىٰ مَيْسَرَةٍ وَأَنْ تَصَدَّقُوا خَيْرٌ لَّكُمْ إِنْ كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ

تَعْلَمُونَ

“Por, në qoftë se ai (borxhliu) është në gjendje të vështirë, atëherë bëni një pritje derisa të vijë në një çlirim. E t’ia falni (borxhin) në emër të lëmoshës, ajo, nëse e dini, është shumë më e mirë për ju.”⁵⁷

Në një hadith thuhet:

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ مَنْ أَحَبَّ أَنْ يُظِلَّهُ اللَّهُ فِي ظِلِّهِ فَلْيَنْظِرْ مُعْسِرًا أَوْ لِيَضَعْ لَهُ

⁵⁴ Tirmidhiu në Sunenin e tij, nr. 1853; Ibni Maxhe në Sunenin e tij, nr. 221. Hadithi është autentik.

⁵⁵ Muhamed Ali Sabuni, *Fikhul Muamelat*. vëll. I, fq. 168.

⁵⁶ AbdulAdhim Bedevij, *El-Vexhiz*, fq. 364.

⁵⁷ Kur’ani, Bekare: 280.

“Ka thënë i Dërguari i Allahut [paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të]: “Kush dëshiron që Allahu t’i bëjë hije me hijen e Tij, le ta presë (afatizojë) borxhliun e gjendjes së vështirë, apo le t’ia falë atë.”⁵⁸

Borxhi nuk duhet të sjellë përfitim

Ajo që duhet theksuar këtu te borxhi është fakti që borxhi nuk duhet të sjellë përfitim, por të kthehet sipas sasisë apo vlerës së marrë, përndryshe kalon në kamatë. Ngase me borxh synohet ndihma e njerëzve dhe lehtësimi në punët e tyre, e jo të bëhet borxhi si mjet shfrytëzimi e përfitimi. Një rregull e jurisprudencës thotë: “Çdo borxh që sjell fitim (dobi), konsiderohet kamatë.”⁵⁹ Ndalesa këtu është e kufizuar me kushtëzimin e dobisë prej borxhit dhe nëse kjo është bërë traditë.⁶⁰

Mirëpo, nëse nuk është e kushtëzuar dhe nuk është traditë e njohur, i lejohet borxhmarrësit që t’ia rikthejë edhe më mirë sesa që ka marrë,⁶¹ bazuar në hadithin që Muhamedi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) kishte marrë borxh një deve, e pastaj e kishte urdhëruar Ebu Rafi’in t’ia kthejë atij një deve nga devetë e zekatit, por kur ai nuk gjeti të ngjashme, atëherë e ktheu një më të mirë, me urdhrin e të Dërguarit të Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të).

MUDAREBEH

Mudarebeh është formë e organizimit të biznesit, ku sipërmarrësi ofron menaxhimin, por burimet financiare i siguron nga të tjerët, duke ndarë fitimin me financuesit në përqindje sipas marrëveshjes.

Nocioni *el-Mudarebe*⁶² (marrëveshje për tregti), në aspektin gjuhësor, nënkupton lëvizje në tokë, e që është indikacion i një udhëtimi për tregti, ngase zakonisht tregtia kërkon udhëtim⁶³, ndërsa në terminologjinë fetare nënkupton kontratë ndërmjet një pronari që i jep para një njeriu që të tregtojë me to, ndërsa fitimi ndahet sipas marrëveshjes së tyre, derisa humbja është vetëm nga kapitali i pronarit.⁶⁴ Thënë ndryshe, është një marrëveshje mes një pasurie nga njëra anë dhe punës nga ana tjetër.⁶⁵ Punëtori nuk bart përgjegjësinë e humbjes, ai mund ta humbasë punën dhe angazhimin e tij.⁶⁶

Forma e marrëveshjes për tregti është kjo: Njëri person e jep kapitalin e tij, ndërsa personi tjetër kryen punën, fitimi që arrihet nga kapitali i pronarit dhe puna e punëtorit ndahet sipas marrëveshjes së këtyre dy personave, derisa humbja është e përjashtuar nga punëtori dhe i takon kapitalit të pronarit. Kjo marrëveshje mund të arrihet po ashtu ndërmjet një numri pronarësh apo financuesish dhe punëtorëve apo sipërmarrësish.

Këtu duhet theksuar se kjo i ngjason ortakërisë, madje shumë juriistë e konsiderojnë lloj të ortakërisë. Mirëpo, në aspektin tjetër, ngja-

⁶² Banorët e Irakut e quajnë me emrin *Mudarebe*-مضاربة, gjersa banorët e Hixhazit e quajnë me emrin *Karad*-قراض. *Karad* nënkupton ndarje dhe kjo përputhet me vërtetësinë e vet fjalës, ngase pronari ndan një pjesë nga pasuria e tij që të tregtojë me të, sikurse që ndan një pjesë prej fitimit të tij.

⁶³ Abdurrahman el-Xhuzejri, *El-Fikhu Alel Medhahibi-l Erbeati*, vëll. III, fq. 56; Muhamed Ali Sabuni, *Fikhul Muamelat*, vëll. II, fq. 23; AbdulAdhim Bedevij, *El-Vexhiz*, fq. 359.

⁶⁴ Vehebeh Zuhejli, *el-Fikhul Islamij ve Edil-letuhu*, vëll. V, fq. 3924.

⁶⁵ Ibni Nexhim, *El-Bahru-rr Rraik Sherh Kenzu-d Dekaiik*, vëll. XX, fq. 3.

⁶⁶ Vehebeh Zuhejli, *El-Muamelatu-l Malijetu-l Muasireh*, Daru-l Fikr, Damask-Siri, 2002m, fq. 438.

⁵⁸ Ibni Maxhe në *Sunenin* e tij, nr. 2410.

⁵⁹ Ky rregull është كل قرض جر نفعاً فهو ربا

⁶⁰ Sejid Sabik, *Legjislacioni i traditës së Profetit*, vëll. III, fq. 251.

⁶¹ Muhamed Ali Sabuni, *Fikhul Muamelat*, vëll. I, fq. 172.

son edhe me qiranë, për faktin se punëtori meriton pjesën e tij të fitimit, si shpajim ndaj punës së tij.⁶⁷

Urtësia e saj

Marrëveshja për tregti është bërë legjitime për nevojat e ndryshme të njerëzve, ngase njerëzit ndryshojnë mes vete rrënjësisht në çështjet e tregtisë dhe biznesit. Disa kanë pasuri dhe mall, por janë injorantë në investime, e disa janë të varfër në pasuri, por të mençur dhe vigjilentë në çështjet e shitblerjes, duke i ditur rrugët e investimeve dhe të përfitimeve.⁶⁸ Këtu qëndron edhe urtësia e kësaj kontrate që sjell përfitime të dyanshme dhe përmbush nevojat e të dyja palëve.

Me anë të kësaj pasurie i zoti i saj mund të përfitojë prej përvojës së aksionarit dhe vetë aksionari përfiton nga pasuria. Këtu konkretizohet bashkërendimi ndërmjet pasurisë dhe punës dhe për këtë arsye Allahu i ka ligjëruar kontratat, për të realizuar interesat dhe nevojat e njerëzve.⁶⁹

Llojet e saj

Marrëveshja për tregti është dy llojesh: e përgjithshme dhe e kufizuar.⁷⁰

E përgjithshme- është kur një person i jep pasuri një personi tjetër pa ndonjë kushtëzim. Si për shembull: Po ta jap këtë pasuri si marrëveshje për tregti, fitimi është gjysma, një e treta e të ngjashme. Pra, këtu nuk kushtëzohet puna, vendi, koha, mënyra e punës dhe as personi se me kë ky do të takohet e të bëjë tregti.

E kufizuar- është kur një person i jep pasuri personit tjetër si marrëveshje për tregti dhe e specifikon se për ku do të tregtojë, me çfarë malli, në çfarë kohe dhe me cilin person apo me persona të caktuar.

Marrëveshja për tregti, kur kushtëzohet koha dhe personi, është e lejuar tek Ebu Hanife dhe Ahmed, ndërsa e ndaluar te Shafi'u dhe

Maliku, ngase shafitë dhe malikitë e kushtëzojnë që marrëveshja për tregti të bëhet në formë të përgjithshme, pa kufizim.⁷¹

Në rastin e moskufizimit (moskushtëzimit), marrëveshja nuk e specifikon periudhën, vendin e biznesit, vijën specifike të tregtisë, industrinë ose shërbimin si dhe furnizuesit dhe konsumatorët, me të cilët do të kryhet biznesi. Në rastin e kufizuar, nëse punëtori e bën të kundërtën e këtyre kufizimeve, ai është përgjegjësi i vetëm për pasojat.

Të gjitha harxhimet normale që lidhen me biznesin e mudarebesë (marrëveshjes për tregti), por jo harxhimet personale të punëtorit, mund të shkruhen në llogaritë e marrëveshjes për biznes (*mudarebesë*). Punëtorit i takon një pagesë fikse ose një shumë absolute fitimi e specifikuar paraprakisht. Ai ka të drejtë pjesëmarrjeje, përveç harxhimeve normale të biznesit, në fitimet e ndara drejt si shpërblim për shërbimet e tij menaxheriale. Fitimi neto duhet të ndahet ndërmjet sahibul malit (pronarit të pasurisë) dhe mudaribit (punëtorit) sipas një përqindjeje të drejtë dhe me marrëveshje paraprake dhe të specifikuar në mënyrë eksplicite në marrëveshjen për biznes (*mudarebeh*).⁷²

Kushtet e saj

Duhet të plotësohen edhe disa kushte sa u përket dy kontraktuesve, kapitalit dhe fitimit.

Kushtet që duhet të plotësohen te kontraktuesit:

- Sa u përket dy kontraktuesve, e me këtë nënkuptohet që pronari i kapitalit dhe punëtori të jenë të aftë nga ana mendore dhe në moshën madhore. Lejohet kontrata edhe me *dhimmiun* (jomyslimanin që jeton në territorin islam),⁷³ apo me jomyslimanin nëse kapitali është nga ai e

⁶⁷ Vehebeh Zuhejli, *el-Fikhul Islamij ve Edil-letuhu*, vëll. V, fq. 3923.

⁶⁸ Muhamed Ali Sabuni, *Fikhul Muamelat*, vëll. II, fq. 24.

⁶⁹ Sejid Sabik, *Legjislacioni i traditës së Profetit*, vëll. III, fq. 281.

⁷⁰ Sherbini, *Mugni el-Muhtaxh*, vëll. II, fq. 31.

⁷¹ Vehebeh Zuhejli, *el-Fikhul Islamij ve Edil-letuhu*, vëll. V, fq. 3928-3929.

⁷² Grup autorësh, *Hyrje në ekonominë dhe financat islame*, fq. 424.

⁷³ Malikitë e konsiderojnë të papëlqyer (mekruh), nëse dhimmiu nuk vepron me diçka të ndaluar, siç është kamata.

puna nga myslimani, ngase nga myslimani nuk ka frikë se përdor kamatën apo mallin haram.⁷⁴

Kushtet që duhet të plotësohen te kapitali:

- Sa i përket kapitalit kërkohet që ai të jetë në të holla, ngase nuk lejohet në mallra apo pasuri të paluajtshme te pjesa dërrmuese e juristëve, ngase, sipas tyre, nëse kapitali është në mallra, ka mundësi mashtrimi, sepse marrëveshja për tregti mund të shpjerë në mosnjohjen e fitimit gjatë ndarjes për arsye se zakonisht vlera e mallrave njihet në bazë të hamendjes dhe supozimit, e mosnjohja shpie në ngatërresa, kurse ngatërresa në armiqësi.⁷⁵ Mirëpo, nëse kapitali është mallra dhe zotëria i kapitalit i thotë punëtorit që ta shesë mallin në monedha dhe me paratë e mallit të bëjë tregti, atëherë një kontratë e tillë lejohet tek Ebu Hanifja, Maliku dhe Ahmed, ndërsa te Shafiu nuk lejohet.
- Kërkohet që kapitali të jetë i njohur në sasi të caktuar, e nëse nuk është i njohur atëherë nuk lejohet marrëveshja për tregti, ngase mosnjohja e kapitalit shpie në mosnjohjen e fitimit.
- Kërkohet gjithashtu që kapitali të jetë i specifikuar dhe prezent, e jo të jetë borxh, ngase nuk lejohet marrëveshja për tregti me borxh apo me pasuri që nuk është e pranishme, kjo është kusht te pjesa dërrmuese e juristëve, të cilët e konsiderojnë marrëveshjen për tregti me borxh si të paligjshme.⁷⁶ Pasuria nuk kërkohet të jetë e pranishme gjatë lidhjes së marrëveshjes, por ajo kërkohet gjatë shkëmbimit (shitblerjes).⁷⁷
- Gjithashtu kërkohet që kapitali t'i dorëzohet punëtorit, në mënyrë që punëtori të mund të punojë e ta kryejë punën e tij që kërkohet.

⁷⁴ Ebu Beker el-Xhezairi, *Minhaxhul Muslim*, fq. 298.

⁷⁵ Vehebeh Zuhejli, *el-Fikhul Islamij ve Edil-letuhu*, vëll. V, fq. 3932.

⁷⁶ Sherbini, *Mugni el-Muhtaxh*, vëll. II, fq. 310; Ibni Rushd, *Bidajetul Muxhtehid*, vëll. II, fq. 335.

⁷⁷ Abdurrahman el-Xhuzejri, *El-Fikhu Alel Medhahibi-l Erbeati*, vëll. III, fq. 33.

Kushtet që duhet të plotësohen te fitimi:

- Që fitimi të jetë i njohur dhe në sasi të caktuar, ngase qëllimi prej kontratës është fitimi, e mosnjohja e fitimit shpie në prishjen e kontratës dhe anulimin e saj. Nëse ndokush ia jep një mijë euro personit tjetër që të jenë pjesëmarrës në fitim, e nuk ka sqaruar sasinë e fitimit, atëherë kjo kontratë lejohet, por fitimi duhet të jetë përgjysmë, ngase merret në analogji me ortakërinë e cila zakonisht kërkon fitim të njëjtë, ashtu siç i Madhërishtmi ka potencuar: **“...ata janë pjesëmarrës të barabartë në të tretën (e tërë pasurisë)...”**⁷⁸
- Që fitimi i ndarë mes të zotit të kapitalit dhe punëtorit të llogaritet me përqindje, si p.sh. gjysma, një e katërta, një e treta.⁷⁹

SHERIKEH-ORTAKËRIA

Sherikeh është formë e organizimit të biznesit, kur dy ose më shumë persona kontribuojnë për financim dhe menaxhim të biznesit me përqindje të barabarta ose të pabarabarta. Fitimet mund të ndahen në përqindje të barabartë (por jo gjithsesi të tillë) sipas marrëveshjes mes partnerëve. Humbjet, megjithatë, duhet të ndahen në përpjesëtim me kapitalin.⁸⁰

Urtësia e ortakërisë

Urtësia e ortakërisë qëndron në faktin se ajo shërben në interesa dhe bashkëpunim të ndërsjellë në investimet e kapitaleve dhe përfitimet e ndryshme prej tyre. Sikundër shërben për ngritjen e ndërmarrjeve të mëdha prodhuese, industriale, tregtare, bujqësore, vepra kapitale që nuk mund të kryhen nga një individ.⁸¹

⁷⁸ Kur'ani, Nisa: 12.

⁷⁹ Sejid Sabik, *Legjislacioni i traditës së Profetit*, vëll. III, fq. 282.

⁸⁰ Grup autorësh, *Hyrje në ekonominë dhe financat islame*, fq. 68-70.

⁸¹ Vehebeh Zuhejli, *el-Fikhul Islamij ve Edil-letuhu*, vëll. V, fq. 3877.

Bashkimi i burimeve nga dy apo më shumë persona, konsiderohet një shenjë e mirë e udhëheqjes së biznesit bashkërisht me mirë sesa një person i vetëm.

Ortakëria njihet si formë dhe modalitete të ndryshme, si: Ortakëria e pabarabartë (شركة العنان) Ortakëria e barabartë (شركة المفاوضة) Ortakëria në zanat (شركة الأبدان) Ortakëria me pozitë (شركة الوجوه).⁸²

Ortakëria e pabarabartë (شركة العنان)⁸³

Kjo ortakëri nënkupton kur dy apo më shumë persona bëhen ortakë në pasurinë e tyre të përbashkët që të tregtojnë me të dhe fitimi të ndahet mes tyre.⁸⁴ Këtu nuk kushtëzohet barazia në kapital, në punë dhe as në fitim, pra lejohet që kapitali i ndonjërit prej tyre të jetë më i madh se tjetri, lejohet që vetëm njëri prej tyre të jetë përgjegjës për punën, por lejohet të jenë edhe të barabartë në fitim, ashtu si lejohet edhe të mos jenë, sipas marrëveshjes së tyre.⁸⁵

Ky lloj i ortakërisë është dominues dhe më i përhapuri mes njerëzve⁸⁶, ngase këtu nuk kushtëzohet barazia në kapital, i lejohet njërit ortak të ketë 100 mijë euro kapital e tjetrit ortak 50 mijë euro, fitimi mund të jetë i njëjtë apo i ndryshëm, varësisht sipas marrëveshjes së ortakëve.⁸⁷

Ky lloj i ortakërisë lejohet me konsensus të dijetarëve myslimanë. Ibni Mundhiri, për këtë lloj të ortakërisë, ka thënë: “Është e lejuar me

⁸² Sipas shumicës së dijetarëve janë katër lloje të ortakërisë në kontratë (sipas shafive, malikive dhe disa dijetarëve), ndërsa hanefitë thonë se janë tri lloje, por secili lloj i ka dy nënllloje të tjera, gjersa hanbelitë thonë se janë pesë gjithsej.

⁸³ Ka mendime se ‘inan’ vjen nga ofrimi i diçkaje, ngase secili ortak ofron diçka tjetrit. Por ajo që është më e njohur rreth emërimit me këtë emër, siç thotë edhe Sebkiu, se është: “Është e huazuar nga frerët e shtazës, ata e drejtojnë shtazën, sikurse që secili ortak merr frerët e tjetrit që nuk e lejon të veprojë siç do ai vetë, por vetëm sipas marrëveshjes. Shih: *Muhtesaru-t Tahavi*, fq. 107; Sherbini, *Mugni el-Muhtaxh*, vëll. II, fq. 212.

⁸⁴ Edhe humbjet nëse ndodhin duhet të ndahen mes tyre, pra fitimi e humbja duhet të ndahet mes tyre.

⁸⁵ Sejid Sabik, *Legjislacioni i traditës së Profetit*, vëll. III, fq. 323.

⁸⁶ Vehebeh Zuhejli, *el-Fikhul Islamij ve Edil-letuhu*, vëll. V, fq. 3881.

⁸⁷ Muhamed Ali Sabuni, *Fikhul Muamelat*, vëll. II, fq. 12.

konsensus të dijetarëve, por disa dijetarë kanë mendime të ndryshme në disa prej kushteve të ortakërisë.”⁸⁸

Kushtet e kësaj ortakërie:

Për të qenë e vlefshme kjo ortakëri duhet të aplikohen këto kushte:

- Të jenë të dy ortakët myslimanë; ngase nuk i besohet jomyslimanit se nuk do të punojë me kamatë apo nuk do të fusë mall/pasuri të ndaluar (haram), përveç atëherë kur shkëmbimi (shitblerja) është në dorën e myslimanit, në këtë rast lejohet ngase nuk ekziston frika e futjes (depërtimit) të mallit të ndaluar në ortakëri.⁸⁹
- Kapitali i pasurisë të jetë i njohur dhe i ditur nga secili ortak, ngase fitimi dhe humbja janë të lidhura me njohjen e kapitalit dhe aksioneve. Mosnjohja e kapitalit dhe aksioneve të ortakëve shpie në marrjen/ngrënien e pasurisë së tjetrit në mënyrë të padrejtë, e kjo pa dyshim se është e ndaluar, bazuar në fjalët e Allahut, i cili thotë: **“Dhe mos e hani pasurinë e njërit-tjetrit në mënyrë të palejuar...”**⁹⁰
- Fitimi të jetë sipas aksioneve, ngase nuk i lejohet që njëri të thotë: “Çka të fitohet prej këtij malli kësaj radhe është yti, e çka fitohet prej mallit tjetër është imi.” Kjo gjë konsiderohet mashtrim, e mashtrimi nuk lejohet.
- Kapitali duhet të jetë në monedha, ndërsa ai që ka pasuri e dëshiron të bashkëngjitet në ortakëri duhet llogaritur vlerën e pasurisë në monedha e pastaj të futet në ortakëri, ngase kur mallrat/pasuritë janë të panjohura në vlerë, atëherë edhe fitimi është i panjohur dhe kjo shpie në grindje dhe mosmarrëveshje gjatë ndarjes.⁹¹
- Nëse vdes ndonjëri nga ortakët, atëherë prishet kontrata, ose nëse ndonjëri prej tyre çmendet përsëri prishet kontrata, e trashëgim-

⁸⁸ Ibni Rushd, *Bidajetul Muxhtehid*, vëll. II, fq. 21.

⁸⁹ Ebu Beker el-Xhezairi, **Minhaxhul Muslim**, fq. 296.

⁹⁰ Kur’ani, Bekare: 188.

⁹¹ Sipas malikive lejohet edhe në mallra dhe pasuri, jo vetëm në monedha, ndërsa sipas hanefive nuk lejohet në mallra por patjetër duhet të jetë në monedha.

tarët e të vdekurit, apo familjarët e të çmendurit, mund të zgjedhin ndërmjet vazhdimit të kontratës dhe prishjes së saj.⁹²

Ortakëria e barabartë (شركة المفاوضة)

Kjo ortakëri nënkupton barazinë në kapital, fitim e në mundësi shkëmbimi⁹³ dhe është kontratë mes dy personave apo më shumë se dy sish për të marrë pjesë në një punë të caktuar.⁹⁴ Kjo është një ortakëri e përgjithshme dhe përfshin pothuajse gjitha llojet e tregtisë⁹⁵ dhe njëherësh është më e gjerë sesa llojet tjera të ortakërisë.⁹⁶

Secili nga ortakët obligohet dhe detyrohet si ortaku tjetër dhe ata duhet të përmbushin të njëjtat kushte, pra ata janë garantues në të drejta dhe obligime të ndërsjella në tregtinë dhe investimet e tyre.

Kushtet e kësaj ortakërie:

Për të qenë kjo ortakëri e vlefshme duhet të përmbushen këto kushte:

- Baraspesha në kapital nga dy ortakët, ngase nuk i lejohet që njëri të ketë më tepër pasuri e tjetri më pak, si ta zëmë njëri të ketë njëqind mijë euro e tjetri pesëdhjetë mijë euro, por kushtëzohet që të dytë të kenë kapital investues të barabartë.⁹⁷
- Ngjashmëria në shkëmbim për të vepruar, ngase nuk lejohet që njëri ortak të jetë në moshë të rritur e tjetri i mitur (fëmijë), apo njëri i lirë e tjetri rob.⁹⁸
- Barazia në fe, që nënkupton se ortakët duhet t'i përkasin të njëjtës fe, pra nuk lejohet njëri të jetë mysliman e tjetri jomysliman,⁹⁹

⁹² Ebu Beker el-Xhezairi, *Minhaxhul Muslim*, fq. 297.

⁹³ Vehebeh Zuhejli, *el-Fikhul Islamij ve Edil-letuhu*, vëll. V, fq. 3881.

⁹⁴ Sejid Sabik, *Legjislacioni i traditës së Profetit*, vëll. III, fq. 323.

⁹⁵ Muhamed Ali Sabuni, *Fikhul Muamelat*, vëll. II, fq. 14.

⁹⁶ Ebu Beker el-Xhezairi, *Minhaxhul Muslim*, fq. 298.

⁹⁷ Edhe pse një ortakëri e tillë pothuajse nuk zbatohet në tregti, apo në raste të rralla.

⁹⁸ Muhamed Ali Sabuni, *Fikhul Muamelat*, vëll. II, fq. 15.

⁹⁹ Ebu Jusufi e lejon këtë ortakëri edhe atëherë kur ortakët nuk i përkasin të njëjtës fe, por e sheh këtë si mekruh.

ngase jomyslimani mund të blejë e shkëmbejë alkool e gjëra tjera që janë të ndaluara për myslimanin.

- Secili nga ortakët të jetë garant për tjetrin për shitjet blerjet që duhet të bëjë, siç duhet të jetë edhe i autorizuar prej tij. Kështu, veprimtaria e ndonjërit prej ortakëve nuk vlen, po të jetë më e madhe se veprimtaria e tjetrit.¹⁰⁰ E nëse ndonjëri zotëron më shumë investim/pasuri, atëherë ky lloj kalon në llojin e parë (sheriketu-l inan).

Nëse realizohet barazia në të tëra këto pjesë, ortakëria lidhet dhe secili ortak bëhet autorizues dhe garantues i shokut të tij. Si rrjedhojë e kësaj kontrate, secili ka të drejtë t'i kërkojë llogari partnerit për veprimet e tij. Këtë kontratë e kanë lejuar hanefitë dhe malikitë, por jo Shafiu.¹⁰¹ Shafiu e konsideron këtë lloj si çështje mjaft të vështirë dhe vështirë të gjendet ngjashmëria siç, kërkohet në këtë lloj ortakërie. Realisht ortakëria e barabartë në kuptimin e hanefive është lloj që vështirë mund të realizohet.¹⁰²

Ortakëria në zanat (punë) (شركة الأبدان)

Ortakëria në zanat nënkupton dakordimin e dy personave, apo më tepër se dy personave që të pranojnë një punë, kurse fitimi që arrihet përmes asaj pune të ndahet mes tyre, sipas marrëveshjes.¹⁰³ Këtu partnerët kontribuojnë me shkathtësitë e tyre dhe me përpjekje për drejtimin e biznesit pa kontribuar për kapitalin.¹⁰⁴

Si p.sh., ajo që ndodh mes rrobaqepësve, zanatçinjve, hekurpunuesve, apo ajo që ndodh në ditët tona - qoftë me zanate/mjeshtëri të njëjtë apo të ndryshme - mes një rrobaqepësi dhe rrobaqepësit tjetër, mes dy hekurpunuesve, mes avokatit dhe avokatit, ata bashkohen dhe atë

¹⁰⁰ Sejid Sabik, *Legjislacioni i traditës së Profetit*, vëll. III, fq. 323.

¹⁰¹ Op. cit. vëll. III, fq. 323.

¹⁰² Alij Hafif, *Esh-Sherikat fi-l Fikhi-l Islamij*, fq. 61.

¹⁰³ Abdurrahman el-Xhuzejri, *El-Fikhu Alel Medhahibi-l Erbeati*, vëll. III, fq. 56; Vehebeh Zuhejli, *el-Fikhul Islamij ve Edil-letuhu*, vëll. V, fq. 3887; Ebu Beker el-Xhezairi, *Minhaxhul Muslim*, fq. 297; Muhamed Ali Sabuni, *Fikhul Muamelat*, vëll. II, fq. 16-17; Sejid Sabik, *Legjislacioni i traditës së Profetit*, vëll. III, fq. 324.

¹⁰⁴ Grup autorësh, *Hyrje në ekonominë dhe financat islame*, fq. 428.

që e fitojnë e ndajnë mes vete sipas marrëveshjes së tyre, qoftë ajo ndarje e njëjtë apo e ndryshme.¹⁰⁵

Mirëpo, nuk është kusht që ortakët të jenë të njëjtë me profesione/zanate, ngase lejohet ortakëria mes një inxhinieri dhe mekaniku, ngase me rëndësi është dakordimi i tyre për pranimin e punës në bazë të profesionit. Ndaj kurdo që zanatçinjtë e njëjtë apo të ndryshëm bien dakord, atëherë lejohet, sikurse dakordimi i zanatçinjve të ndryshëm për ndërtimin e shtëpisë/banesave, asfaltimin e rrugëve, apo kompanitë e njëjta që bëjnë eksplorime dhe gjurmime për naftë etj.

Ky lloj i ortakërisë është i lejuar tek malikitë, hanefitë, hanbelitë dhe zejditë, ngase qëllimi nga kjo ortakëri është arritja e fitimit, por shafitë, imamitë dhe imam Zuferi nga hanefitë nuk e lejojnë, duke e konsideruar të pavlefshme këtë ortakëri, ngase tek ta ortakëri konsiderohet vetëm ajo që shkëmbehet me pasuri e jo me punë, ngase asnjëri nuk e di se a do të fitojë apo jo; pra, mund të ndodhë që njëri të fitojë e tjetri të mos fitojë fare, e kjo pa dyshim që do të ishte e padrejtë në ndarjen e fitimit.¹⁰⁶

Kushtet e kësaj ortakërie:

- Secili nga pjesëmarrësit të kërkojë shpërblimin prej punëdhënësit; - Nëse njëri nga ortakët sëmuret apo mungon me ndonjë arsye, atëherë gjithë ajo që është fituar nga njëri ortak ndahet mes të dyve.
- Nëse zgjat mungesa e tij apo sëmundja e tij për një kohë, atëherë duhet bërë zëvendësimin me ndokënd tjetër, kurse shpërblimi i tij bëhet nga hisja e të sëmurit/munguarit; - Nëse mungon (nuk është i pranishëm) ndonjëri nga ortakët, atëherë ortakut tjetër ka të drejtë ta anulojë kontratën e ortakërisë.¹⁰⁷

Ortakëria me pozitë dhe besueshmëri (شركة الوجوه)

Ortakëria me pozitë nënkupton kur dy apo më shumë se dy persona blejnë pa pasur para (kapital), por duke u bazuar në pozitën e tyre dhe besimin që tregtarët kanë ndaj tyre, me qëllim që kjo ortakëri të jetë mes tyre në fitim.¹⁰⁸ Blerja bëhet pa kapital, paratë i dorëzohen shitësve më vonë, ndërsa këta mallin e shesin me të holla të menjëherëshme dhe kjo kryhet në bazë të pozitës së tyre dhe besueshmërisë që kanë te njerëzit.¹⁰⁹ Fitimi dhe humbja janë sipas pjesëmarrjes së tyre, zakonisht edhe fitimi edhe humbja janë të barabarta,¹¹⁰ por nuk është kusht të jenë të barabarta, ngase mund të jenë edhe fitimi edhe humbja të ndryshme, gjithnjë sipas marrëveshjes dhe pjesëmarrjes së tyre.¹¹¹

Kjo formë e ortakërisë është e lejuar tek hanefitë, hanbelitë dhe zejditë, ngase konsiderohet kontratë që përmban autorizim/ përfaqësim (توكيل) ortakut për ortakun e tij në shitje e blerje dhe secili e autorizon ortakun e tij për shitblerje. Por edhe njerëzit kanë vepruar ngjashëm me këtë nëpër shekuj dhe askush nuk e ka refuzuar këtë. Sipas tyre, kjo llogaritet si lloj pune, ndaj lejohet një lloj i tillë i ortakërisë.¹¹²

Ndërsa malikitë, shafitë dhe dhahiritë janë të mendimit se ky lloj i ortakërisë është i pavlefshëm, ngase ortakëria lidhet me pasuri (mall) dhe punë, ndaj të dyja këto elemente të rëndësishme nuk ekzistojnë në

¹⁰⁸ Sejid Sabik, *Legjislacioni i traditës së Profetit*, vëll. III, fq. 324.

¹⁰⁹ Vehebeh Zuhejli, *el-Fikhul Islamij ve Edil-letuhu*, vëll. V, fq. 3885-3886; Abdurrahman el-Xhuzejri, *El-Fikhu Alel Medhahibi-l Erbeati*, vëll. III, fq. 56

¹¹⁰ Ebu Beker el-Xhezairi, **Minhaxhul Muslim**, fq. 298

¹¹¹ Kjo për faktin se te hanefitë ky lloj ndahet në dy nënllaje të tjera: Ortakëria me pozitë dhe besueshmëri të barabartë (شركة الوجوه مفاوضة) ku kushtëzohet që të dytë të jenë të barabartë në blerje dhe fitim dhe ortakëria me pozitë e besueshmëri të pabarabartë: (شركة الوجوه عنانا) ku nuk kushtëzohet që ortakët të jenë të barabartë në blerje dhe fitim, por lejohet që njëri të blen më shumë se gjysmën, tjetri pjesën e mbetur, po ashtu edhe fitimi mund të ndryshojë. El-Kasani, *Beda'iu-s Sanaiu fi Tertibi-sh Sherai*, vëll. VI, fq. 63.

¹¹² Ibn Hemmam, *Fet'hu-l Kadir*, vëll. V, fq. 30; Ibni Kudameh, *El-Mugni*, vëll. V, fq.12.

¹⁰⁵ Muhamed Ali Sabuni, *Fikhul Muamelat*, vëll. II, fq. 17.

¹⁰⁶ Sherbini, *Mugni el-Muhtaxh*, vëll. II, fq. 212.

¹⁰⁷ Ebu Beker el-Xhezairi, **Minhaxhul Muslim**, fq. 297-298.

këtë çështje.¹¹³ Sipas këtyre të fundit, nuk ka kapital të përbashkët mes ortakëve, e këtu mund të ketë mashtrim.

Përfundim

Brenda këtij punimi u munduam ta paraqesim kamatën si një dukuri shkallmuese, e cila po zhyt shoqërinë në mjerim dhe alternativat që Islami ofron. Ndonëse brenda një punimi është e vështirë të mbli-dhen tematika të tilla, mirëpo jam munduar që gjërat thelbësore t'i sqaroj.

Mr. Ejup Haziri

INTEREST AND ISLAMIC ALTERNATIVES

(Summary)

Introduction

In this paper we will discuss the concept of interest as a very negative phenomenon, which has ruined individuals, societies and states. We will discuss the reasons why interest is prohibited in Islam. We will discuss the two types of Riba and the reasons why they were prohibited. We will present provisions having to do with Riba and will provide Islamic alternatives to it (credible institutions, which act in harmony with Islamic laws). Islam has prohibited Riba but on the other hand has offered alternatives to it.

أيوب حازيري

الربح و البدائل الاسلامية

(خلاصة البحث)

تقديم

نتطرق الى موضوع الربح كظاهرة مهلكة هلكت أفرادا و مجتمعات و هلكت دولا و قوى عظمى. و سوف نتناول الربح كظاهرة محرمة و أسباب حرمانها و سوف نتطرق الى نوعين معروفين من للربح و أسباب حرمانها . كذلك سوف نتناول الادلة الشرعية التي تتعلق بالربح و في النهاية سوف نتناول البدائل الاسلامية حيث سنذكر الامكانيات المختلفة بحيث أن الناس يطلبون المساعدة في المؤسسات الموثوقة وفقا للمبادئ الاسلامية و لدى أفراد يساعدون بعضهم بعض و خاصة عندما يكونوا في حاجة الى المساعدة. والاسلام عندما حرم شيئا ذكر أسباب تحريمه و في نفس الوقت قدم بدائل لها.

¹¹³ Ibn Rushd, *Bidajetu-l Muxhtehid ve Nihajetu-l Muktesid*, vëll. II, fq. 252.

Qemajl Morina

GJUHA ARABE NË VENDET ISLAMIKE

Gjuha arabe për shkak të lidhjes së saj që ka me Kur'anin, librin e shenjtë të myslimanëve, me të cilën bëjnë ibadet sot mbi një miliard e gjysmë myslimanë nga të gjitha meridianët e botës. Këtu qëndron edhe rëndësia e madhe që besimtarët e fesë Islame i kushtuan kësaj gjuhe, ashtu siç shihet nga ky studim bibliografik të cilin po ua prezantojmë lexuesve të revistës "Edukata Islame".

Në këtë mënyrë shohim se si Islami i tërhoqi shumë popuj joarabë te gjuha arabe dhe ajo u përhap në shumë vende të botës, në të cilat arabët nuk kishin kurrfarë ndikimi në ato vende. Historia na tregon se si arabishtja doli prej Gadishullit Arabik me ekspeditat e para islame dhe për një kohë shumë të shkurtër ajo u bë gjuhë e banorëve të Shamit, Irakut, Egjiptit, Sudanit si dhe vendeve tjera. Me këtë shohim se ajo i tejkalon kufijtë e të qenit gjuhë e fesë, duke u bërë gjuhë e popujve dhe gjuhë e shteteve.

Kështu pra edhe sot e kësaj dite, Islami ka ndikimin e tij në përhapjen e arabishtes në vendet joarabe. Ky ndikim i tejkalon ndikimet e qendrave kulturore, të cilat i shohim të përhapura në të gjitha anët e botës, në përhapjen e gjuhëve, siç janë frëngjishtja dhe anglishtja. Dihet mirëfilli se pronarët e këtyre qendrave kulturore shpenzojnë miliona dollarë për çdo vit për të propaganduar kulturën si dhe përhapjen e gjuhëve të tyre, ndërkohë që islami i bën popujt myslimanë, që vetë ata të kërkojnë ta mësojnë gjuhën arabe.

Gjuha arabe në vendet islamike

- 1.Ndikimi i islamit në Afrikë, Ebul Vefa Et-Taftazani, Alemul Fikr, nr. 1, 1971, f.301-316
- 2.Ndikimi i kulturës arabe në disa gjuhë afrikane, Neim Kuddah, hulumtim shkencor, nr. 28, 1398 h, f. 317-323
- 3.Ndikimi i gjuhës arabe në botën islame, Denison Rus, revista Errisale, Egjipt, nr. 5, viti 1, f.17-18
- 4.Ndikimi i gjuhës arabe në botën islame, Denison Rus, revista Errisale, Egjipt, nr. 5, viti 1, f.20-21
- 5.Ndikimi i gjuhës arabe në gjuhën tagjike, Husejn Ali Mahfudh, revista e Institutit të Gjuhës Arabe në Bagdad, vëll. 12, 1384 h
- 6.Ndikimi i gjuhës arabe në gjuhën persiane dhe mundësia e lehtësimit të mësimin të arabishtes për ata që flasin persishten, Ahmed Hasan al-Xhelis, Revista Arabe për studime gjuhësore, nr.1, vit. 1, f.128-129
- 7.Letërsia arabe në subkontinentin indian, Abdul Maksud Shilkani, revista El-Ez-her, nr.6, viti.47, f. 683-696
- 8.Islami dhe arabishtja në Sudan: studime mbi civilizimin dhe gjuhën, Avni Sherif Kasim, Bejrut, Darul Xhejl, 1409 h, f.391
- 9.Islami dhe gjuha arabe në Afrikën Perëndimore, IbrAdhim Ali Turhan, rev. e Fakultetit të Filologjisë, Universiteti i Kajros, nr.1, vit.27, f.51
10. Islami dhe gjuha arabe në më Afrikën Perëndimore, IbrAdhim Ali Turhan, rev. El-Menhel, nr.12,vit.37, f.1259-1271
11. Islami dhe gjuha arabe në të ardhmen e Afrikës së Re, Mahmud Sharkavi, rev. El-Ez-her, nr. 7, vit. 33, f. 818-826.
12. Horizontet e mësimin të gjuhës arabe dhe ballafaqimi me vështirësitë në Azinë Jug-indore, dr. Abdurrahman Betshik, rev. Islamijetul Marifeh,nr. 12, 18/ 1419 h, f.159-190.
13. Fjalë arabe në gjuhët evropiane, dr. Abdul Aziz Berham, rev. e Fakultetit të Sheriatit dhe Studimeve Islame, nr.1/93-1994.

14. Fjalët e huazuara nga arabishtja në gjuhën savahili, dr. Davud Selum, rev. e Fakultetit të Filologjisë, Universiteti i Bagdatit, nr.19/1976, f.219-293.
15. Fjalët e huazuara nga arabishtja në gjuhën jurba, dr. Davud Selum, rev. e Fakultetit të Filologjisë, Universiteti i Bagdadtit, nr. 20/1976.
16. Njeriu, kultura dhe gjuha në Afrikën Subsahariane, dr. Abdul Hajj Abdul Hak, rev. Ethe kafetu Es-sudani jetu, nr. 9-10, shkurt 1979-1980, f. 7-31.
17. Përhapja e gjuhës arabe, rev. El-lisan El-arabij, nr.22, f.338-340.
18. Përhapja e gjuhës arabe, rev. El-lisan El-Arabij, nr.22, f.354-355.
19. Përhapja e gjuhës arabe, rev. El-lisan El-arabij, nr. 24, f.319-320.
20. Përhapja e gjuhës arabe në Afrikën Perëndimore gjatë historisë, Es-sirr Ahmed El-Iraki, rev. Dirasatun fikrijetun, nr. 1, f.101-116
21. Hulumtime rreth marrëdhënieve mes arabishtes dhe gjuhëve afrikane, Ahmed el-Ajid, Revista Arabe për Studime Gjuhësore, nr.1, f.9-38
22. Hulumtime rreth marrëdhënieve mes gjuhës arabe dhe gjuhëve afrikane, Ahhmed el-Ajid, rev. El-lisan El-arabij, nr.23, f. 59-63
23. Disa probleme me të cilat ballafaqohet havasavi në shqiptimin e tyre, Thani Umer Musa, rev. El-lisan El-arabij, nr.37/1413
24. Ndikimi i ndërsjellë mes gjuhës arabe dhe turqishtes në kohën e osmanlinjve, IbrAdhim Ahmed Hidr Ed-dakuki, Regvan: Qendra për studime dhe hulumtime osmane dhe moriskite, 1988
25. Ndikimi i gjuhës arabe në gjuhët afrikane në përgjithësi, Dir Deheb Figjenda, Tunizi, OAEKSH, 1985, Marrëdhëniet mes kulturës arabe dhe asaj afrikane f.164-166
26. Përvoja e Institutit të Shkencave Islame dhe Arabe në Indonezi në fushën e mësimin të gjuhës arabe për jo arabët, Memduh Nurud-din Abdu Rabbu En-nebij, Xhakartë: Instituti Saudit për Shkenca Islame dhe Arabe, 1409- 1988, f. 20-32

27. Përvoja e mësimit të gjuhës arabe për jo arabët në Institutet e Arabisë Saudite dhe dobia e fituar nga universitetet indoneziane, Hamed bin Nasir Ed-dehil, Revista e Universitetit El-Imam Muhamed bin Saud El-Islamije, nr. 9, f 329-362
28. Zhvillimi i gjuhës arabe në Pakistan, Dr. Madhhar Muin, Vjetari i Universitetit Islamik Ndërkombëtar, nr. 2 1994, f. 239
29. Arabizimi i Afrikës i mundshëm dhe i nevojshëm, IbrAdhim Abdullah Muhamed, Menar El-Islam, Ebu Dhabi, nr. 12, dhulhixhe 1403
30. Mësim arabo-islam në kontinentin e Afrikës, Muhamed Bejumi, revista El-Va'ju El-Islamij, nr. 270, viti, 23, f. 52-57
31. Mësimi i arabishtes nëpërmjet radios në Gambi, Muhamed Hasen Bakla, Universiteti i mbretit Saud, dekanati i bibliotekave, 1400/ 1980, referenca: konferenca e parë ndërkombëtare e mësimit të arabishtes për jo arabët, Instituti i gjuhës arabe pranë Universitetit të mbretit Saud, f. 301-314
32. Mësimi gjuhës arabe në institutet islame sot: metoda procedurale, mjetet e mësimit, mësuesit dhe nxënësit, ambienti i brendshëm, Instituti saudit i shkencave arabe dhe islame, Xhakartë, 1409, f. 24-30
33. Mësimi i gjuhës arabe në Pakistan, Abas Hidr, revista Errrisale, Egjipt, nr. 871, viti, 18, f. 311-312
34. Mësimi dhe gjuha arabe në Jug të Sudanit, Dr. Abdul Aziz El-xhelal, revista e Institutit të mësimit të gjuhës arabe në Universitetin Umul Kura, nr. 2 1404. f. 367-399
35. Mësimi dhe nxënia e gjuhës arabe në Nigeri, Is-hak Ugniye, Revista Fejsal, nr. 50, viti 5, f. 72-77
36. Përmirësimi i programit të mësimit të gjuhës arabe në Pakistan, Hamed bin Nasir Ed-dehil, revista e Universitetit të El-Imam Muhamed bin Suud El-Islamije, nr. 3, f. 71-205
37. Simetri gjuhës arabe dhe greke, At Anstam Mari el-Kermeli, revista e Institutit të Gjuhës Arabe, Kajro, 1353 h
38. Zhvillimi i gjuhës arabe dhe përhapja e kulturës arabe-islame jashtë, revista El-lisan El-arabij, nr. 24, f. 255-257

39. Rekomandimet e Konferencës shkencore rreth kulturës islame dhe gjuhës arabe në Afrikën Perëndimore dhe në jug të Sahrasë, vjetari universitetit në Niger, nr. 2/1417 f.301
40. Kolonitë arabe në Afrikë, Ahmed Ida Salim, revista El-Mustakbel El-arabi, nr. 5, viti, 6, f. 97-107
41. Alfabeti arab dhe gjuhët afrikane, Jusuf Ebu Bekr El-Halife, revista Kultura sudaneze, nr. 20, tetor 1983, f.35-45
42. Lëvizja tregtare, Islami dhe mësimi islam në Afrikën Perëndimore, Gr. Mehdi Rizkallah Ahmed, 1/1419 h
43. Rreth marrëdhënieve mes përhapjes së Islamit dhe përhapjes së gjuhës arabe, Abdul Aziz bin Muhamed El-Gunam, revista El-Menhel, nr. 4, viti, 34, f. 541-542
44. Studimet arabe në vendet islame jo arabe: e kaluara, e tashmja dhe çka pritet në të ardhmen, Es-sejid Muhamed Jusuf, revista El-mugjtema', nr. 355. viti 8, f. 34-36
45. Studimet gjuhësore në Irak në gjysmën e parë të shekullit njëzet, Abdul Xhebar Xhafer Vehib El-Kazaz, Bagdad, Fakulteti i Filologjisë, Universiteti i Bagdadit, 1399/979, f. 344
46. Kurs trajnimi në hartimin e fjalorit arab për të huajt, revista El-lisan El-arabij, nr. 18, f. 198-201
47. Lidhjet gjuhësore mes Indisë dhe arabëve, Dr. Xhemil Ahmed, revista e Institutit të gjuhës arabe në Damask, vëllimi 4, sheval 1395 h
48. Imazhe të rilindjes së kulturës arabe në Afrikën Perëndimore, Neim Kudah, revista El-ma'rife, nr. 39, viti i katërt
49. Universaliteti në gjuhën arabe, Muhamed Mustafa ibn El-Haxh, revista El-arabi lithekafeti, nr. 19, viti 10, f. 65-84
50. Agresioni në arabishten është agresion në Islam, Muhamed bin Abdurrahman Es-subejhin, El-mexhel-letul Arabijetu, nr. 188, viti 17, f. 50-51
51. Arabishtja në zemër të Afrikës, Neim Kudah, El-ma'rife, 29, 1965
52. Arabishtja, gjuhë e Islamit dhe myslimanëve, (13), Ali Abdul Adhim, revista e El-Az'harit, nr, 9, viti 44, f. 887-893, 896

53. Arabishtja, gjuhë e Islamit dhe myslimanëve, (15), Ali Abdul Adhim, revista e El-Az'harit, nr. 3, viti 45, f. 258-266
54. Arabishtja, gjuhë e Islamit dhe myslimanëve, (16), pozita ndër-kombëtare, Ali Abdul Adhim, revista e El-Az'harit, nr. 6, viti 45, f. 558-594
55. Arabishtja, gjuhë e Islamit dhe myslimanëve, (17), obligim islam, Ali Abdul Adhim, revista e El-Az'harit, nr. 1, viti 45, f. 963-969
56. Arabishtja, gjuhë e islamit dhe myslimanëve, (18) gjuhë ndërko-mbëtare, Ali Abdul Adhim, Revista e El-Az'harit, nr. 1, viti 46, f. 87-94
57. Arabishtja, gjuhë e Islamit dhe myslimanëve (19), Ali Abdl Adhim, revista e El-Az'harit, nr. 2, viti 46, f. 219-226
Doktrina e lëvizjes vehabiste në parim bën pjesë në doktrinën tradicionaliste islame, si vazhdimësi e shkollës hanbeliste, me specifika të caktuara. Kjo specifikë e vendos tradicionalizmin vehabist nga ai *skolastikë* në *tradicionalizmin selefist*. Karakteristikë e kësaj tendence është se në qasjen dhe leximin e teksteve (nusus) refuzojnë ndërmjetësimin e shkollave juridike dhe të ulemasë për të cilën bëjnë thirrje ata. Komentimi i Kur'anit dhe i sunetit bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe shkon jashtë kufizimeve që i kanë vendosur medhhebet.⁸ Njëri ndër autoritetet e lëvizjes selefiste në shekullin XX, Abdulkadër Arnauti, në një shkrim, shkruan: “...Sepse, ngatërrohet perceptimi korrekt i besimit të njerëzit me atë që është i huaj, nën ndikimin e atyre të cilët kanë shkruar për këtë çështje pa dije të mjaftueshme, as që u përpoqën të kthehen në veprat e ulemasë së parë të ehlis-sunetit, të cilët e përpunuan këtë lëndë themelësisht dhe nuk lanë vend për kurrfarë shtese...”.⁹ Më konkretisht, kjo do të thotë se tradicionalistët selefistë e zhvilluan doktrinën (metodikën – menhexhin) e pasimit të vetëm “të të parëve korrektë” (selef’us-salih), me çka pranojnë vetëm praktikën e grupit të caktuar të dijetarëve islamë, e cila i kënaq kriteret e tyre në pasimin e praktikës së Muhammedit a.s. Këta janë një grup i vogël i shkollës së ehl’ul-hadithit.¹⁰

Ehl’ul-hadithi dhe ehl’ul-fikhu

Asnjëri nga juristët (fakihët) e respektueshëm myslimanë, në asnjë çast dhe në asnjë rrethanë nuk e konteston legjitimitetin e hadithit/sunetit si dëshmi valide në fe pas Kur’anit. Por, dallimet lindin në qasje ndaj burimeve dhe në metodat për nxjerrjen e dispozitave. Dallohen kryesisht dy koncepte të të kuptuarit të sunetit: i pari, i cili kufizohet në perceptimin e fjalëpërfjalshëm të tekstit me sa më pak “implikime të arsyes”, grup i cili njihet me emrin *ehl’ul-hadith* dhe i dyti, i cili synon për gjetjen e kuptimit dhe urtësisë nga fjalët e theksuara duke i dhënë rol edhe arsyes, në mënyrë që tekstet t’i kuptojë dhe të gjejë zgjidhje analoge, grup i cili njihet me emrin *ehl’ul-fikh*.¹¹

Këto dy qasje janë të vjetra sa edhe vetë suneti, kurse për bazë e marrin një ndodhi para betejës me fisin Benu Kurejdha në vitin e pestë hixhrij. Ndodhia ishte si vijon: Pejgamberi a.s. i urdhëroi një grupi shokësh që të shkojnë te fisi Benu Kurejdha dhe që askush të mos falë ikindinë (Buhariu) përkatësisht drekën (Muslimi). Kur hyri koha e namazit, as’habët u ndanë në dy grupe, në ata që e kuptuan fjalëpërfjalshëm porosinë e Muhammedit a.s. dhe nuk u falën derisa arritën deri në vendin e përcaktuar nga Pejgamberi a.s. dhe në ata që e falën namazin, duke e arsyetuar se me këtë Pejgamberi a.s. ka dashur të thotë të nxitojnë. Me të kthyer, as’habët e pyetën Muhammedin a.s. për këtë që ndodhi, kurse ai i miratoi të dyja qëndrimet.¹²

Kjo praktikë vazhdoi edhe pas vdekjes së Muhammedit a.s., te as’habët, sikurse janë ata që e kanë përdorë arsyen (ra’jin) në raste të caktuara (Omeri r.a., Aliu r.a. Abdullah ibn Mes’udi etj) dhe ata që i kanë kuptuar gjerat fjalëpërfjalshëm (Abdullah ibn Umeri, Abdullah ibn Amr ibn Asi, Zubejri etj.).¹³ Kjo gjendje do të vazhdojë edhe më

⁸ Shih: Tarik Ramadan, Biti evropski musliman, Sarajevë, 2002, fq. 292-293.

⁹ Abdulkadër Arnauti, parathënie në: Stazom ispravnihi prethodnika, Aman, Jordani, fq. 6-7, sipas: Muhamed Jusic, Islamisticki pokreti, Zenica, 1426/2005, fq. 13.

¹⁰ Më gjerësisht lexo: Muhamed Jusic, po aty, fq. 13-15.

¹¹ Muhamed Jusic, po aty, fq. 15.

¹² Shih Buhariun dhe Muslimin, sipas: Muhamed Jusic, po at, fq. 16.

¹³ Abdulkerim Zejdan, El-Med’halu li diraset’ish-sheri’at’il-islamijeh, Aleksandri, (-), fq. 106.

tej, gjatë periudhës formative të fikhut, kelamit dhe shkencave të tjera, por edhe më vonë. Përfaqësuesi kryesor i doktrinës së *ehl'ul-hadithit* është Ahmed ibn Hanbeli (780-855), themeluesi i hanbelizmit. Kjo shkollë nuk arriti të shtojë numrin e vetë në asnjë kohë deri në kohën e Muhammed Abdulvehhabit, kur kjo shkollë u bë doktrinë zyrtare e Arabisë. Kjo lëvizje gjatë argumentimit të tyre thirren jashtëzakonisht shumë edhe në dijetarët Ibn Tejmije dhe Ibn Kajjim Xhevzije.

Simbioza ndërmjet dinastisë saudite dhe doktrinës vehabiste

Të diskutosh për lëvizjen vehabiste pa e diskutuar familjen saud është e pamundur. Fillimet e këtij bashkëpunimi çojnë deri në vitin 1744, kur Muhammed ibn Abdulvehhabi, i refuzuar nga familja dhe qyteti i tij, në kërkim të gjetjes së rrethanave favorizuese, erdhi në kontakt me kreun e rebeluar të dinastisë saude në qytezën Der'ije, konkretisht me Muhammed ibn Saudin. Këta dy liderë ambiciozë u dakorduan ndërmjet veti për një koalicion, të cilin do ta mbronin *“qoftë edhe me armë ta konstituonin qeverisjen e fjalës së Zotit dhe ta pasttronin Islamin nga të gjitha risitë.”*¹⁴ Kjo marrëveshje u vazhdua edhe në vitin 1792 ndërmjet pasardhësve të tyre, por do të vazhdojë deri në ditët tona.¹⁵

Aleanca së shpejti filloi të japë rezultate, duke u shtrirë në pjesët qendrore dhe lindore të Arabisë. Pastaj u shtri edhe në pjesët e tjera të vendit, duke e pastruar, në pajtim me doktrinën e tyre, çdo shenjë që e konsideronin risi apo të papajtueshme me mësimin e tyre. Ata rrënuan tyrbet, zavitë e varrezat, kurse njerëzit që refuzonin nënshkrimin i ekzekutonin. Kjo gjendje e nderë bëri që shteti osman të mbledhë forca dhe ta godasë këtë lëvizje dhe në vitin 1818 ta shuajë. Mirëpo, aleanca u përtëri, kështu që në vitin 1821, sërish u riorganizua me kryeqytetin

¹⁴ Muhammed Jusic, po aty, fq. 18.

¹⁵ Nexhat Ibrahim, Zhvillimi i sekteve në historinë e mendimit islam, Tetovë, 2007, fq. 126.

e ri Rijadin. Por edhe kjo tentativë nuk pati sukses.¹⁶ Aleanca vehabito-saudite me në krye me princin Abdulaziz u përpoq edhe për së treti herë në vitin 1901, duke e ripushtuar Rijadin, dhe duke e shtrirë sundimin edhe në pjesë të tjera të vendit.¹⁷ Mbreti, për ta qetësuar vendin bëri ca reforma ekonomike, organizoi disa kooperativa dhe i ndërtoi disa xhami në mënyrë që ta defaktorizojë fuqinë fisnore dhe ta instalojë vëllazërinë fetare, sepse problemet kryesore vinin pikërisht nga fiset gjysmautonome. Por, as aktiviteti politiko-ushtarakë nuk mbeti me kaq. Mbreti i vetëshpallur në vitin 1915, lidhi një marrëveshje me anglezët, që ata ta pranojnë pavarësinë e Arabisë, kurse Arabia do t'i përkrahte interesat angleze në rajon, e sidomos nëse do të ishin aktiv kundër Shtetit Osman. Kjo rezultoi edhe me marrëveshjen e fshehtë Sykes-Picot në vitin 1916, në dëm të myslimanëve por në dobi lokale. Për karakterin e dëmshëm të marrëveshjes flet vetë protagonistin kryesor i kësaj marrëveshje, T. E. Lawrence: *“Kam rrezikuar mashtrimin për shkak të bindjes se ndihma e arabëve ka qenë medoemos e nevojshme për fitoren tonë të lirë dhe të shpejtë në Lindje dhe se është më mirë ta shkelim fjalën tonë dhe të fitojmë se sa të humbim.”*¹⁸ Në këto luftime humbën jetën mbi 100 mijë myslimanë. Për shkak të këtyre lidhjeve të dëmshme me anglezët rivalët e quajten vëllazërinë siameze saudo-vehabiste si “spiunë britanikë” dhe kjo akuzë vazhdon të bëhet edhe tash, duke i ndërruar pjesërisht aktorët, në vend të britanikëve kryesorë tash janë amerikanët, si “spiunë amerikanë”.

¹⁶ El-Abud, El-Akidet'ush-shejh Muhammed ibn Abdu'l-vehhab es-selefijjeh ve etheruha fi'l-alemi'l-islamijj, II, Medinë, 1419 h., fq. 257-294.

¹⁷ Gjerësisht për kthimin e saudëve në Arabi, shih rrëfimin e hollësishëm në veprën: Muhammed Asad, Rruga për në Mekë, Shkup, 2003, fq. 225 e tutje.

¹⁸ T. E. Lawrence, Seven Pillars of Wisdom, Cape, London, 1935, fq. 24, sipas: F. William Engdahl, Stoljece rata – Anglo-americka nafta politika i novi svjetski poredak, Zagreb, 2000, fq. 75, 100 dhe 368.

Dy përfaqësuesit kryesorë të vehabizmit gjatë shekullit XX

Lëvizja vehabiste gjatë të kaluarës ka pasur figura të rëndësishme. Sidomos gjatë shekullit XX i dalluan disa, por dy njerëzit që me jetën dhe veprën e tyre lanë gjurmë më të thella janë: Abdulaziz ibn Abdullah ibn Bazi dhe Muhammed Salih El-Uthejmini.

1. Abdulaziz ibn Abdullah ibn Bazi

Personaliteti më i rëndësishëm i lëvizjes vehabiste në shekullin e XX ishte Abdulaziz ibn Abdullah ibn Bazi. U lind në vitin 1912 në Rijad. Ka kryer detyra të rëndësishme brenda organizatës fetare. Një kohë ishte rektor i Universitetit të Medinës. Kohën më të madhe dhe sidomos kohëve të fundit ishte myfti i Arabisë Saudite. Përkundër fraksionizmit brenda lëvizjes, ai mbeti autoritet. Mirëpo, jo çdoherë shkonte puna mirë. Me rastin e invadimit të Irakut në Kuvajt më 1990 dhe rrezikut për të depërtuar në Arabi, Ibn Bazi u gjet ndërmjet skillës dhe haribdes. Edhe dijetarët edhe princat brenda mbretërisë nuk ishin unanim të lejojnë trupat e huaja brenda mbretërisë. Madje ai deklaroi se në rrethana të veçanta myslimanëve iu lejohet të kërkojnë ndihmë nga jomyslimanët, madje në një fetva tjetër deklaroi se lufta kundër Irakut është xhihad. Nga kjo kohë, një numër pasuesish të vehabizmit u larguan nga ai, madje disa duke e akuzuar si “shërbëtor të tagutit” (liderit jobesimtar). Ndër të rebeluarit ishin Selman El-Avde dhe Sefer El-Havali, të cilët u vendosën në krye të një peticioni drejtuar mbretit në vitin 1982, në të cilin kërkonin verifikimin e raporteve me Amerikën, çrënjosjen e korrupsionit dhe nepotizmit etj. Pas daljes në opinion të këtij peticioni, që për mbretërinë ishte një precedent i paparë dhe skandal, gjendja u ashpërsua. Në këtë gjendje kur duhej marrë anën, Ibn Bazi u vu në anën e mbretit dhe iu kundërvu opozitarëve edhe pse deri atëherë ishte mësues i tyre. Pas një kohe të shkurtër Ibn Bazi e dha për mbretërinë edhe një fetva të diskutueshme, me të cilën lejohej

nënshkrimi i marrëveshjes paqësore me Izraelin në Lindjen e Afërme, fetva kjo që e irritoi rëndë Usama ibn Lladenin. Para vdekjes, Ibn Bazi e ashpërsoi kursin ndaj mbretërisë kurse në favor të opozitarëve.¹⁹ Vdiq në vitin 1999, duke lënë një vakum në vendin udhëheqës.

2. Muhammed Salih El-Uthejmini

Vendin e liderit në lëvizjen vehabiste pas vdekjes së Ibn Bazit e zuri Muhammed Salih El-Uthejmini. U lind në vitin 1926. Ai vetëm një kohë të shkurtër e mbajti këtë pozitë meqë vdiq pas dy vjetësh pune. Për shkak të rrethanave të rënduara por edhe të kohës së shkurtër, Uthejmini nuk arriti të bëjë riparimet e duhura në lëvizjen vehabiste. Vdekja e tij më 10 janar 2001, hapi një hendek të ri, kush do ta zë këtë pozitë me rëndësi. Në vdekjen e tij morën pjesë shumë zyrtarë dhe mbi 500 mijë banorë.²⁰

3. Periudha post-Uthejmin

Vdekja e Uthejminit e ndërlikoi edhe më gjendjen e lëvizjes vehabiste. Figurat e larta si Muhammed Ali Shejh, Abdulmuhsin Et-Turki, pastaj Salih ibn Fevzan, Bekr Ebu Zejd e të tjerë nuk gëzonin autoritet të mjaftueshëm për të zënë vendin e liderit. Kjo gjendje bëri që ambiciet karrieriste të lulëzojnë, kështu që kemi në varg emrash që pretenojnë për të parin e lëvizjes. Ky problem është i gjallë edhe në Jordani ndërmjet Nasrudin Albanit, Muhammed Ibrahim Shakra, Alij Halebiut, Muhammed Ebu Ruhajmit, El-Makdesit e të tjerë. Disa prej tyre përfaqësonin rrymën tolerante, njëfarë bashkëjetese me regjimin, dhe disa të tjerë që përfaqësonin “selefizmin burimor” dhe vendosjen e ligjeve të forta në frymën rigoroze. Ky hendek nuk u mbyll, por u hap edhe më tepër dhe nuk ka gjasa për të përfunduar në të mirë. Këtë e themi duke e marrë parasysh faktin se çdo ditë kemi njerëz të rinj,

¹⁹ Muhamed Jusic, po aty, fq. 22-26.

²⁰ Muhamed Jusic, po aty, fq. 27 dhe 30-31.

përfaqësues të rinj, të cilët pretendojnë se janë të vetmit në rrugë të drejtë.²¹

Përfundim

Lëvizja vehabiste në fillim të shfaqjes dhe aktivitetit të saj kishte çdo karakteristikë të lëvizjes së mirëfilltë. Ajo nuk karakterizohej me tipare sektariste, përjashtuese, anatemuese, urbidale dhe gjenocidale. Ajo përbënte një vazhdim të shkollës hanbeliste në kohë dhe rrethana të reja. Por, ballafaqimi me jetën reale të lëvizjes dhe veprimet gjithnjë e më të ashpra kundër jobashkëmbimtarëve e futi këtë lëvizje në rendin e sekteve, si në rrafshin organizativ ashtu edhe në rrafshin fetar e politik. Edhe pse shumë i propaganduar, ixhtihadi, ky mekanizëm i domosdoshëm në Islam, u shpërfill, duke ndjekur rrugën e formalizimit të skajshëm.

Meqë një gjendje e tillë është e paqëndrueshme në shtigje të gjata, është për të shpresuar që gjatë shekullit XXI vehabizmi do t'i kthehet bazës, shumicës myslimane, do ta zbusë fjalorin përjashtues dhe mallkues dhe do të jetë faktor pajtimi e uniteti e jo si deri tash faktor destruktiv në skenën fetare e politike të myslimanëve në botë.

Nexhat Ibrahim

WAHHABISM OR THE CALL OF MUHAMMAD IBN ABDUL WAHHAB

(Summary)

Introduction

The Salafist movement was born as a result of the teachings/actions of Muhammad Ibn Abdul Wahhab (1703-1787), who was a reformer from the Arabian Peninsula. Wahhab was born in Uyayna, a village in the region of Najd. His family was from a line of scholars of the Hanbali School of jurisprudence. His father was a judge, whereas, his brother, Sulayman, had a religious background. Following his return from Iraq, Iran and the other countries he had visited he was criticized because of his extreme views, which resulted in him seeking other places to present them.

نجد ابراهيمي

الحركة التقليدية الوهابية أو دعوة محمد بن عبد الوهاب

(خلاصة البحث)

تقديم

التقليديون المسلمون أو السلفيون هي الحركة التي ولدت نتيجة للتدريس و عمل المصلح من شبه الجزيرة العرب الشيخ محمد بن عبد الوهاب (١٧٠٣-١٧٨٧) . ولد في بلدة عبيدة قريبا من العاصمة الرياض بمنطقة نجد من اسرة معروفة . كانت تنتمي الى المذهب الحنبلي . كان أبوه يعمل قاضيا في بلدته و كان أخوه سليمان يحمل مؤهلات علمية في مجال العلوم الدينية أيضا . بعد عودة محمد من العراق و ايران حتى أبوه و أخوه لم يوافقا على أفكاره الغربية مما جعله يطلب مكانا آخر لكي يقدم و ينشر أفكاره .

²¹ Po aty, fq. 28-29.

PUBLICISTIKË

Nuridin Ahmeti

ÇËSHTJA ÇAME (Sipas gazetës “DAJTI” të Hafiz Ibrahim Dalliut)

Hyrje

Konferenca e Ambasadorëve në Londër, e vitit 1913, e cila ishte mbledhur për t’u dhënë zgjidhje problemeve ballkanike, jashtë shtetit të ri shqiptar la gati gjysmën e territoreve shqiptare; Kosovën, pjesën shqiptare të Maqedonisë dhe Çamërinë, të cilat në mënyrë permanente iu nënshtruan përndjekjes dhe shkombëtarizimit.

Ashtu si fati i shqiptarëve të tjerë të mbetur jashtë trungut të shtetit amë, edhe fati i shqiptareve të Çamërisë ishte tragjik dhe i dhimbshëm. Tragjedia çame kishte jo vetëm aspektin territorial, por edhe njerëzor.

Qëndrimet e qeverive greke ndaj komunitetit shqiptar në Çamëri, pas shpërbërjes së Perandorisë Osmane dhe pushtimit të kësaj krahine nga Greqia më 1913 e deri më sot, kanë qenë në funksion të zhbërjes se çdo gjëje shqiptare dhe greqizmit të saj me emigrantë nga Azia e Vogël.

Athina zyrtare nuk ua ka njohur asnjë të drejtë kombëtare shqiptarëve të Çamërisë, përdorimi i gjuhës shqipe ka qenë i ndaluar, si në shkollë ashtu edhe në përdorim publik.

Ky koncept shovinist ishte përcaktuar në dy drejtime:

1. Ndaj shqiptarëve të besimit ortodoks, politikën e asimilimit, duke i privuar nga çdo e drejtë etnie, kulture, apo gjuhësore, duke i konsideruar grekë, pra ngatërronin me qëllim fenë dhe kombin, veprim që e bëjnë edhe sot ndaj shqiptarëve, duke pretenduar se të gjithë ortodoksët janë grekë.
2. Ndaj shqiptarëve të besimit islam aplikuan politikën e gjenocidit dhe shfarosjen, duke mohuar gjithashtu etninë. Në shumë raste me qëllim i kanë konsideruar turko-çamë dhe jo shqiptaro-çamë.

Ajo që do t’i pllakosë çamët në shpirt edhe më shumë janë veprimet e shtetit grek në vitet 1923-1924, e që pa mëdyshje se për popullatën e kësaj ane do të jenë vdekjeprurëse. Marrëveshja e Lozanës, e janarit të vitit 1923 midis Turqisë dhe Greqisë, për shkëmbimin e turqve myslimanë me grekët e Anadollit do t’i jepte konotacion tjetër nga qarqet zyrtare greke, sepse midis turqve myslimanë do të përfshihen edhe çamët myslimanë me origjinë shqiptare që banonin në Greqi edhe pse përfaqësuesi i Qeverisë greke më 19 janar 1923 në Lozanë deklaroi, se qeveria e tij nuk kishte aspak ndërmend t’i fuste në shkëmbim, myslimanët me origjinë shqiptare.

Në kundërshtim me realitetin historik dhe marrëveshjeve të arritura, shteti grek detyron forcërisht këmbimin e çamëve, që arrijnë disa dhjetëra mijëra veta, duke realizuar në atë kohë një pjesë të planit të kahershëm për një spastrim etnik të minoritetit autokton.

I gjendur i tmerruar përballë kësaj politike represive dhe hegjemoniste të shtetit grek, njeri nga patriotet më në zë të kohës së tij Hafëz Ibrahim Dalli, si kryeredaktor i gazetës “Dajti,” që asokohe botohej në Tiranë, do t’i kushtojë në faqet e kësaj gazete këtyre tragjediave një vëmendje të veçantë, duke u bërë zë i fuqishëm në sensibilizimin e opinionit vendor dhe atij ndërkombëtar për represionin dhe përndjekjen e popullit çam nga autoritetet e shtetit grek.

Dy fjalë për gazetën “Dajti” të Hafëz Ibrahim Dalliu

Gazetë e përjavshme politike, ekonomike dhe letrare. Numri i parë doli më 5 janar 1924 në Tiranë; vijoi deri në nr. 125. Doajeni dhe studiuesi i gazetarisë shqiptare Hamit Boriçi, kur bën fjalë për gazetën që dilyn në fillim të shek. XX, ndër të tjera, shkruan: “Xhoka” dhe “Dajti” ishin dy gazeta që u botuan në Tiranë, por jehona e tyre u dëgjua edhe në qytetet kryesore të Shqipërisë..., “Dajti”, e drejtuar nga Hafëz Ibrahim Dalliu, një prej figurave përparimtare e demokratike të klerit muhamedan në Tiranë. Ajo filloi botimin më 5 janar 1924..., i kushtoi vëmendje të veçantë luftës kundër opinionit patriarkal, feudal, të prapambetur. Kjo gazetë shquhej për rubrikën “Dajti në gaz”, e cila botohej në faqe të parë dhe kishte autor vetë kryeredaktorin e fletore, publicistin H. I. Dalliu. Përmes humorit e satirës, stigmatizohej e vjetra, kritikoheshin mbeturinat feudale në jetën qytetare; përcilleshin ide e mesazhe përparimtare e demokratike. Në 125 numrat e saj, “Dajti” e ruajt natyrën, përmbajtjen, përparimtare e demokratike.¹

Gazeta “Dajti” për tragjedinë çame

Në faqet e gazetës “Dajti” çështja çame zuri një vend merit. Me këtë rast do të sjellim disa nga numrat e saj, ku lexuesi ka rastin të shohë se në ç’mënyrë dhe çfarë dimension i jep kjo gazetë çështjes çame dhe raporteve shqiptaro-greke në përgjithësi. Edituesit e saj pothuajse në çdo numër ia kushtonin nga një shkrim fatit të popullsisë çame, duke u shndërruar në një organ që po denonconte para publikut vendor dhe atij ndërkombëtar politik shfarosëse të shtetit grek, i cili në intencë për të realizuar idenë nacionaliste të Megali Idesë synonte shkombëtarizimin, jo vetëm ndaj Çamërisë, por edhe pushtimin e Jugut të Shqipërisë. Në këtë shkrim do të trajtojmë artikullin e gazetës

“Dajti” nr. 42, të datës 6 gusht 1924, me titull: “Populli çam dhe kabineti Noli”², në të cilin është dhënë një tablo e përgjithshme e sjelljeve më çnjerëzore të autoriteteve të shtetit grek ndaj komunitetit shqiptar në krahinën e Çamërisë; “Autoritetet greke, me sjelljet e tyre çnjerëzore për çrrënjosjen e popullit shqiptar të Çamërisë, kujtojnë që realizojnë qëllimet imperialiste të Megali-idesë së tyre qesharake, në dëm të popullit dhe të shtetit shqiptar,” thekson shkrimi në fjalë, duke vënë në dukje qëllimet djallëzore të Athinës zyrtare ndaj shqiptarëve. Njëherësh, përmes këtij artikulli gazeta “Dajti” i bën me dije kabinetit Noli, që çështjen çame duhet marrë shumë seriozisht; “Jemi të sigurt se Kabineti Noli do t’i marri gjithë masat që i lyp nevoja, interesi dhe nderi i Shqipërisë; edhe shpresojmë se do të ketë nevojë t’ia kujtojmë herë tjetër Qeverisë detyrën e saj,” vinte theksin në artikullin e saj kjo gazetë shqiptare.



Ndërsa më 7 nëntor 1924, gazeta “Dajti” në nr. 53, me titull: “Çamëria në vajtim bijtë e saj në panik!”, i bënte të njohur opinionit mbarëshqiptar për përndjekjen dhe mizoritë e shtetit grek ndaj kësaj popullate, respektivisht vinte theksin te mënyra çnjerëzore e dëbimit të çamëve nga vendbanimet e tyre. Artikulli në fjalë përfundonte me një apel, ku thuhej: “Në emër të njerëzimit e të interesave kombëtare, bëjmë apel, për të fundit herë, në ndërgjegjen e popullit e të Qeverisë

¹ Hamit Boriçi, Një shekull e gjysmë publicistikë shqiptare (1848-1997), Tiranë, 1997, f. 84, 85.

² “Dajti” nr. 42, dt. 6 gusht, Tiranë, 1924, f. 1.

shqiptare që t'i ndejnë dorën e shpëtimit racës shqiptare të Çamërisë, e cila po s'u interesuat juve me shpirt, është e dën timer të humbasë për jetë! Popull, Shyp, djalëri, është detyra e juaj njerëzore e atdhetare të detyroni Qeverinë shqiptare të zbatojë dëshirën e juaj të vërtetë-(Tiranë më, 19-IX- 24, Zëri i Çamërisë)”³. Po në këtë numër kemi edhe një shkrim me titull; “Një sy mbi Çamërinë”, ku vë në spikamë qëndrimin delegatit italian Montagna, gjatë nënshkrimit të Traktatit të Lozanës, i cili ka mbrojtur popullin çam duke u bërë më dije autoriteteve të nënshkrimit se këta nuk duhet të konsiderohen si turq.

ÇAMËRIJA NË VAJTIM BIJT E SAJ NË PANIK!

Populli thejesht Shqiptar i Çamërisë ka 12 vjet që shtrydhet pa mëshirë nga ana e autoriteteve grekë, nënë rrobërin e pa durushme politike dhe ekonomike. Vrasjet, grabitjet dhe gjithfarë soj torturash barbare, direkt dhe indirekt, në kurrik të pakicës shqiptare të pa mprojtje në Greqi, kan filluar qysh në vjetin 1913 edhe në të katër vjetet e fundit kanë vazhduar me reptësin e pa shëmbëlltë.

Sjelljet shnjërzore të naltpërmendura të autoriteteve Grekë në Çamërin e mjeruar, kanë qëne veglat dhe mjetet kryesore të qëllimit të grekëve: për depatrimin e shqiptarëve të Çamërisë. Propagandat dhe manevrat sistematike të grekëve për at qëllim e prunë rezultatit e dëshiruar për ta, se

Nji sy mbi Çamëriën.

Në jugën e Epirit që nga Kapo-Stilua e Konispolit e deri afër qytetit të Prevezës gjithë breg-deti me një Hinderland 50 k.m. ndodhet thejesht shqiptar, dhe populli i saj quhet Çam. Këta banuësa t'atij vendi Shqiptar nga rasa, nga gjuha, ashtu edhe nga koncjensi janë Shqiptarë.

Mbas Traktatit të Lozanit që asht bamun midis Greqis dhe Turqis në kategorien e ndrëshimit si për bazë asht marun vetëm Feja, dhe jo kombësia; por delegati Italian i atij Konferenci Z. Montagna në shpiegimet që ka dhanun të cilat edhe sot mund të shifen në Proces-verbalet e atij Konferenci, ku ka mbrojtur mjaft bukur dhe me drejtësi popullin Çam, të cilët nuk duhen të konsiderohen si Turqë edhe as që duhen të përshihen n'artikullat që i përkasin ndrëshimit midis turqëve dhe grekëve.

Populli Çam, jo si duan ta interpretojnë Grekët dhe Fillogrekët se janë Turq edhe pretendojnë të venë në Turqi, por disa prej tyre nga shtrëngesa dhe nga tiranija e bandavet greke dhe të qeveris lokale për të shpëtuar nderin dhe jetën e tyre, kundra vulnetit dhe dëshirës së tyre, bënë disa demarche të këfilla; kurse zani i

Kurse në nr. 58, të dt. 11 dhjetor 1924, kjo gazetë sjell shkrimin: “Sjelljet e Greqisë kundrejt Shqipërisë”, të ideologut të çështjes shqiptare nga Kosova, Hasan Prishtina, i cili me një stil plot nerv diplomatik dhe patriotik vë në pah interesat, siç thotë ai, të përbashkëta të dy popujve fqinj për ekuilibrimin e çështjes në Ballkan. Duke qenë një diplomat me eksperiencë të gjatë, Hasan Prishtina ka edhe sugjerimet e tij në këtë artikull, kur thotë së Qeveria shqiptare është treguar tolerante kundrejt grekëve në territorin shqiptar, duke u dhënë të drejtat e tyre si në shkollim, gjuhë e etj., andaj me plot të drejtë Hasan Prishtina konstaton: “Pra edhe na kemi të drejtë me lyp prej Greqisë sjellje reciproke për shqiptarët që banojnë në Greqi edhe sidomos për Çamëri. Duhet Greqia me iu dhënë edhe shqiptarëve të drejtat e pakicave, sikundër që ua dha bullgarëve që banojnë në Greqi.”⁴ Gjithashtu,

³ “Dajti”, nr. 53, dt. 7 nëntor, Tiranë, 1924, f. 3.

⁴ “Dajti”, nr. 58, dt. 11 dhjetor, Tiranë, 1924, f. 2.

Hasan Prishtina thekson se zgjidhja e çështjes çame dhe dhënia të drejtave të tyre do të ishte shkak për zhdukjet e mosmarrëveshje mes këtyre dy kombeve, që sipas tij, janë më të moçmit kombe në Ballkan, “që kanë pasur një lidhje historike ndërmjet vete prej shumë shekujsh”⁵.



Vuajtjet e vëllazënve tanë çamër,”⁶ është shkrimi tjetër i gazetës “Dajti” nr. 98, të datës 24 shtator 1925, ku publikohet një telegram nga Saranda të përfaqësuesit të përgjithshëm të popullit shqiptar të krahinës së Çamërisë, zotëri Adem Mehmet Klefit, të cilin telegram ia dërgon Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, ku potencon ardhjen e komisionit ndërkombëtar në Çamëri, trysnitë e autoriteteve greke ndaj popullatës shqiptare për ta mohuar kombësinë para komisionit, konfiskimi i pasurisë nga na e autoriteteve greke ndaj atyre që deklarorin se janë shqiptarë, dhe njëkohësisht me anë të këtij telegrami kërkohet nga Qeveria shqiptare të marrë masa diplomatike, siç thuhet: “....për shpëtimin e një pjese të kombit shqiptar nga këto mizori, këto mizori e padrejtësi të jashtë njerëzishme”⁷.

⁵ “Dajti”, nr. 58, dt. 11 dhjetor, Tiranë, 1924, f. 2.

⁶ “Dajti”, nr. 98, dt. 24 shtator, Tiranë, 1925, f. 3.

⁷ “Dajti”, nr. 98, dt. 24 shtator, Tiranë, 1925, f. 3.

Vuejtjet e Vllazënvet t’ onë Çamër

Nji tragjedi pa shemëll në botë

Kina bamë fjalë në numër 98 dhe 99 të Dajtit mbi mizorinat e autoritetvet Grek kundrejt Çamvet.

Të vujtunat e vllazneve, t’ onë të të Filat, Margëlliç, Ajdunat dhe Prevezë nuk vinë nga faji ose nga vullneti i Çamvet, ashtu si kan dashtun t’ a rrëfejnë Grekrit, por nga intrigat dhe nga pa drejtësit e bamuna prei

Vuejtjet e vllazënvet t’ onë Çamër

TELEGRAM NGA SARANDA

Sarandë, më 19-IX-1925

Ministrisë së P. të Jashtme

Komisioni që erdhë në Çameri për shkoqitjen e kombësisë, tue filluar nga puna, prej anës Qeverisë Greke filluan të bëhen ma të mbëdhatë mizori e shtërngime për të mohuar kombësinë dhe tue shtërnguar popullin atjeshme që të thonë jemi turqë e jo shqiptar. Pasuninë otoriteti grekë ja u ka konfiskuar ma të shumënit [e] popullit të atjeshme që thotë se jemi shqiptarë enternohen prej Qeveris Greke. Këto vepra vërtetohen me firmat që pasojnë me poshtë duke vërtetuar dhe nga Bashkija Kōnispolit. Dhe të internuarit janë këto: Damin Mete, Sim Hanxhi. Tasin Malkua dhe tjerë. Lusim pranë asajë kryesije me pasë mirësinë e me marrë masat diplomatike për shpëtimin e nji pjesës së kombit shqiptar me shpëtue nga këto mizori e pa drejtësi të jashtë njerëzishme.

Përfaqësuesi i përgjithshëm i popullit shqiptar të anës Çamerisë

ADEM MEHMET KLEFTI
Kōnispol, 18-IX-1925.

Edhe në numrat tjerë gazeta “Dajti” publikon shkrime dhe artikuj, përmes të cilëve pasqyrohet qëndrimi antishqiptar i shtetit grek dhe intenca e tij për shkombëtarizimin e Krahinës së Çamërisë, duke ndryshuar dhunshëm strukturën etnike në dobi të elementit grek, respektivisht duke vendosur emigrantë grekë dhe vllahë në pronat dhe vendbanimet shqiptare pa asnjë kompensim.

Kush ishte Hafëz Ibrahim Dalliu?

(1878-1952).Veprimtar i Lëvizjes Kombëtare dhe demokratike, Hoxhë (Hafëz), publicist, lëvruer i letërsisë artistike. U lind në Tiranë, ku kreu Medresenë. Vioji studime e larta në Stamboll. Shërbeu në vendlindje si hoxhë (hafëz) dhe mësues. Dha mësim në shkollën e parë shqipe në Tiranë (1898). Më 1908 hapi shkollën shqipe të vajzave në Tiranë. Mori pjesë në Kongresin Elbasanit në vitin 1909, dhe së bashku me Luigj Gurakuqin dhe Aleksandër Xhuvanin, Hafëz Ibrahim Dalliu që nga të parët që themeloi Normalen e Elbasanit, e cila u hap me vendim të Kongresit të lartpërmendur. Ishte njëri nga themeluesit dhe drejtuesit e klubit patriotik “Bashkimi” në Tiranë, dhe e përfaqësoi atë në Kongresin e Manastirit në vitin 1908, u bashkua me çetën e kryengritësve kundraxhon-turke të Sarisalltektut më 1911. Mori pjesë në Kuvendin Kombëtar të Vlorës, më 1912, pas vitit 1921 zhvilloi veprimtari të gjerë politike e shoqërore.⁸ Gjatë viteve 1920-1924 mori pjesë në lëvizjen demokratike.

Pas vitit 1912, Hafëz Ibrahim Dalliu iu kushtua publicistikës dhe letërsisë, drejtoi gazetën politike “Dajti”. Duke nisur nga viti 1918 deri më 1924, botoi një varg veprash, islame, satirike, patriotike etj.⁹

Ndër veprat e tij janë; “Dokrrat e hinit”(1920), “Patriotizma në Tiranë”(1930), “Tefsiri shqip i Kur’anit” në dy vëllime, përkthyer nga arabishtja. “Udha muhamedane”, Tiranë më, 1936, etj.¹⁰

U përndoq, u burgos, maltretua nga xhonturqit, gjatë pushtimit italian, gjatë monarkisë së A. Zogut dhe diktaturës së Enver Hoxhës.

Përfundim

Nga materialet e lartshënuara të gazetës “Dajti” lidhur me çështjen çame, mund të përfundojmë se, informacioneve që vinin nga Çamëria dhe që kishin të bënin me represionin e shtetit grek ndaj popullatës shqiptare të kësaj ane, për dëbimet, vrasjet përdhunimet, shpronësimet e dhunshme, kjo gazetë u bë një dritare dhe një zë i fuqishëm për denoncimin e politikave antishqiptare të Athinës zyrtare. Natyrisht, një meritë të veçantë për këtë punë kaq të çmueshme e ka drejtori i saj përgjegjës, Hafëz Ibrahim Dalliu, i cili u kujdes përherë që në faqet e gazetës “Dajti” çështja çame të kishte një hapësirë të veçantë, respektivisht që informacionet nga Çamëria të jenë shumë herë kryelajm dhe për këtë ato editoheshin në ballinat e saj.

Po kështu, nga kërkimet e bëra mund të themi së “Dajti” ishte ndër gazetatat e vetme të kohës që i kushtoi një rëndësi të veçantë fatit të popullit çam dhe vuajtjeve të tij nën okupimin e shtetit grek, i cili me të gjitha mjetet bëri që kjo krahinë të greqizohet tërësisht, të mbetet pa asnjë shqiptar. Gjithashtu vlen të shtohet se kjo gazetë çështjen çame nuk e trajtoi si një çështje të rastit, por ajo ishte e interesuar që çështja e çame gjithmonë të jetë lart në listën e shkrimeve të saj si një çështje që duhet denoncuar fuqimisht dhe në vazhdimësi.

⁸ Ibrahim Hasnaji (Hima), Hafiz Ibrahim Dalliu (jeta dhe vepra), në: “Ditura Islame”, nr. 64, Bashkësia Islame e Kosovës, Prishtinë, 1995, f. 64.

⁹ Hafiz Ibrahim Dalliu, Veprat letrare, Botime Enciklopedike, Tiranë, 2000.

¹⁰ Ismail Bardhi, Hafiz Ibrahim Dalliu dhe ekzagjeza e tij kur’anore, Logos- A, Shkup, 1998.

Nuridin Ahmeti

THE CHAM ISSUE (Excerpt from the Dajti Newspaper – Hafiz Ibrahim Dalliu)

(Summary)

In an effort to solve the problems of the Balkans, the Conference of the Ambassadors, which was held in London in 1913, left almost half of the Albanian territories outside the borders of the newly created state of Albania (Kosova, the Albanian part of Macedonia and Chameria).

The fate of the Albanians from Chameria was tragic as was the fate of the other Albanians left outside the borders of their fatherland. Apart from its territorial aspect the Cham tragedy had a humane aspect as well.

نور الدين أحمد

قضية تشامريه (حسب حريدة "دايتي" لحافظ ابراهيم داليو) (خلاصة البحث)

تقديم

ان مؤتمر السفراء الذى عقد فى لندن سنة ١٩١٣ بشأن حل المشاكل لدول البلقان الا انهم تركوا خارج الدولة البانيا الجديدة اكثر من نصف الاراضى الالبانية مثل كوسوفا و الاراضى لالبانية فى مكدونيا و منطقة تشامريا فى اليونان و التى مع الاسف الشديد باستمرار خضعت لعملية الملاحقة و التجريد من الجنسية . و بهذا الصدد يمكن القول كما كان حظ يقية الالبان الذين بقوا خارج حدود الدولة الام كذلك كان حظ البان تشامريا كان مأسويا و محزنا و المأساة تشامريا لا تتعلق بالارض فقط بل هى تتعلق بالجانب الانسانى اكثر .

FOKUS

Mr. Rexhep Suma

ETIKA ISLAME NË KOMUNIKIM

Komunikimi dhe vlerat etike kanë qenë një pjesë instrumentale dhe integrale e Islamit, që nga fillimi i shpalljes së tij. Përgjatë shekujve, kultura, qytetërimi dhe civilizimi islam kanë qenë me ndikim në zhvillimin e tri shtyllave kryesore të komunikimit njerëzor:

Së pari, në nivel të lartë të komunikimit me gojë dhe kulturës në të cilën informacioni është prodhuar dhe transmetuar nga personi në person.

Së dyti, një shkallë të paparë të librave dhe dorëshkrime të riprodhuara të cilat shënojnë një epokë intelektuale të ndërveprimit të pasur shkencor, letrar, artistik dhe gjuhësor në të gjitha fushat e dijes.

Dhe së treti, përpjekja e parë në histori për të sjellë kulturat gojore dhe të shkruara në një kuadër të unifikuar, krijimin e terrenit për revolucionin shkencor, që pasoi më vonë në kontinentin Evropës.

Etika ka të bëjë me rregullat e sjelljes ose parimet morale që na orientojnë për të vepruar në mënyrën më të drejtë në një situatë të caktuar. Ndër vite filozofët kanë zhvilluar një numër parimesh të përgjithshme etike, që shërbejnë si orientime për të vlerësuar sjelljen tonë.

Prej më se një shekulli, studimet për komunikim e kanë vënë theksin në mediet e komunikimit masiv për shkak të risive që ato kanë sje-

llë, duke hyrë në jetën e përditshme të shumicës së individëve që nga fundi i shekullit XIX. Por, ekziston një arsye tjetër për këtë suses: mediet e komunikimit masiv përbëjnë faktin komunikativ më origjinal dhe më përcaktues në shoqëritë e orientuara në demokraci. Ato implikojnë njëherësh tri dilemat mbi universet tona të përkatësisë, duke bërë të mundur vendosjen e një marrëdhënie të shpejtë dhe të përherëshme midis popujve dhe kulturave përmes imazheve, teksteve dhe tingujve (pa marrë parasysh mjetet e komunikimit dhe regjimet e mëparshme politike).¹

Parimi i së mesmes së artë

Virtyti moral shtrihet mes dy ekstremesh. Ky pozicion filozofik lidhte veçanërisht me Aristotelin, i cili, si biolog vërejti që ushqimi i tepërt është po aq i dëmshëm për shëndetin, sa edhe ushqimi i pamjaftueshëm. Çelësi qëndron te modelimi. Në të njëjtën mënyrë, në diletat etike mënyra e duhur e sjelljes gjendet midis tepërimit dhe të bërit pak.

Shembujt e së *mesmes së artë* gjenden shpesh në praktikën e medies. Për shembull, kur kompanitë e lajmeve raportojnë për trazira civile, ato përpiqen të jenë të përmbajtura. Ato ekuilibrojnë nevojën për të informuar publikun me nevojën për të ruajtur sigurinë publike, duke mos irrituar audiencën.

E domosdoshmja kategorike

Është parim universal, që ajo që është e drejtë për një është për të gjithë. Filozofi gjerman Emanuel Kant njihet gjerësisht për këtë direktivë etike të tij. Për të matur korrektësinë e sjelljes sonë, Kanti këshillonte të vepronin sipas rregullave që do të donin t'i shihnin të zbatuara universalisht. Sipas formulës së Kantit, kategorike do të thotë e pakushtëzuar, e pazbutur nga rrethanat, pa përjashtime e drejta është e drejtë dhe duhet bërë, nuk ka rëndësi se ç'pasoja ka. Nëse, pas kryerjes së

¹ Eric Maigret, Sociologjia e komunikimit dhe medieve. Tiranë, 2010, Botimet Papirus, f.18.

një veprimi ndihemi të shqetësuar ose fajtorë, mbase kemi shkelur ndërgjegjen tonë. E zbatuar në komunikimin masiv, e domosdoshmja kategorike mund të ketë kuptim që të gjitha format e mashtrimit në mbledhjen e lajmeve janë të gabuara dhe duhet shmangur. Askush nuk do që mashtrimi të bëhet një praktikë universale. Prandaj, për shembull, një reporter nuk duhet ta paraqesë vetveten si të ndryshëm nga të tjerët, kur mbledh informacione për një lajm.

Parimi i dobishmërisë

Dobishmëria është përcaktuar si përfitimi më i madh në numër të madh. Mendimi modern utilitarist e ka origjinën te filozofët e shekullit XIX, *Jeremy Bentham* dhe *Jon Stuart Mill*. Doktrina bazë në formulimet e tyre është se ne e përcaktojmë ç'është e drejtë apo e gabuar, duke marrë në konsideratë raportin e së mirës ndaj të keqes për shoqërinë në përgjithësi. Utilitaristët pyesin se sa promovohet e mira dhe sa shmanget e keqja nga mënyra e ndryshme e sjelljes. Ata japin një metodë të qartë për vlerësimin e zgjedhjeve etike:

1. Llogarit të gjitha pasojat, të mira e të këqija që do të rezultojnë nga secila prej alternativave tona, pastaj
2. Zgjidh alternativën që maksimalizon vlerën ose minimizon humbjen. Po të shohim fushën e komunikimit masiv mund të gjejmë lehtë disa shembuj të vjedhur qeveritarë, të njohur si dokumentet e Pentagonit. Me sa duket gazeta që e bëri këtë mendoi se e mira që do të arrihej duke botuar këto dokumente ishte më e rëndësishme se dëmi që mund të shkaktohej prej tyre. Vini re se (perspektiva e Kantit do të sugjeronte një drejtim të ndryshëm veprimi. Vjedhja është e keqe, gazetatat nuk duan që qeveria t'i u vjedhë pronën, prandaj s'ka pse të pranojnë apo nxisin vjedhjen e pronës qeveritare). Ose merrni rastin e një gazete të vogël perëndimore, që vendosi të denonconte vdekjen e një adoleshenti, i cili u largua nga qyteti, iu fut rrugës së prostitucionit e drogës dhe u vra. Gazeta mendoi se përfitimet potenciale të kësaj historie, si paralajmërimi ndaj pri-

ndërve të tjerë, ishin më të mëdha se hidhërimi që mund t'i shkaktonte familjes vrasja e viktimës.²

Islami si vlerë botërore, është i ngritur mbi bazën e komunikimit të mirëfilltë, qoftë të sferës disiplinare apo interdisiplinare. Manifestimi i vlerave dhe etikës në komunikim nga aspekti i përgjithshëm dhe në gazetari në aspektin më të ngushtë, mbetet një element qenësor në ngritjen dhe prezantimin apo plasimin e informatave apo shpërndarjen e mesazhit. Së këndejmi, Islami është fe e komunikimit, vlerave sublime, që po ashtu në vetvete përcjell mesazhe të vlerave dhe etikës pozitive që janë bazë e ndërveprimit (interaction) njerëzor. Ky artikull paraqet një përmbledhje të kodeve ekzistuese të etikës së medias dhe analizon ndikimin e tyre në praktikën e medias masive. Ajo pastaj tenton të zhvillojë një perspektivë islame e masive të etikës së medias, duke u fokusuar në udhëzimet morale të ofruara nga Kur'ani dhe tradita e Profetit Muhamed a.s.(Sunetin). Gjithashtu shqyrton çështjet, problemet dhe sfidat në operacionalizimin e këtyre udhëzime të realizueshme në një kod të etikës. Në fund, udhëzime specifike janë paraqitur për të bërë media me përmbajtje islame praktikues të vetëdijshëm dhe të interesuar për etikën e medias. Disa diskutime gjithashtu janë bërë lidhur me mënyrat e zbatimit të këtyre dispozitave të kodit të etikës.

Mendoj se mediet duhet të jenë shumë më praktike sesa abstrakte dhe filozofike. Megjithatë, të dyja lajmet dhe përcjellin dhe përforcojnë dhe janë të bazuara në besime të caktuara dhe sisteme vlerash. Themelet dhe epistemologjia etike e praktikave bashkëkohore të medievet masive janë të rrënjësura thellë në ideologjinë dhe filozofinë perëndimore. Motivi kryesor prapa të gjitha strukturave të medias, praktikave dhe proceseve është e bazuar në vlerat e shitjes dhe i qeverisur nga mekanizmi i tregut.³

² Joseph R. Dominick, *Dinamika e komunikimit masiv-media në periudhën digjitale*. UET Press, 2000 Tiranë. f. 590

³ Thomas W Cooper. *Communication Ethics and Global Change*. White Plains, NY: Longman, 1989: XI.

Kodi i etikës dhe mekanizmave mbikëqyrës është injoruar nga praktikuesit e medieve, sepse ai kundërshton rendin mbizotërues social dhe pengon ndjekjen e privates. Situata në vendet myslimane ose të praktikantëve të medieve myslimane, nuk është e ndryshme nga ajo e medieve perëndimore.

Format e ndryshme të etikës së medias masive kanë të bëjnë me të drejtat, përgjegjësitë, liritë dhe rregullimin e shtypit kanë qenë të debatuar në kulturat evropiane që nga futja e shtypit në shekujt e 15-të dhe në fillim të shekullit të 16-të. Shumica e këtyre debateve u përqendruan në dy fusha: etika profesionale që lidhet me trajnimin e profesionistëve të medias dhe teoritë normative filozofike të komunikimit publik, të cilat mbajnë në obligimet profesionale të praktikantëve të medias.

Arti i kulturës dhe komunikimit në shoqëritë dhe mesin islam gjeti shprehjen e vet më të mirë në Kur'anin famëlartë dhe Sunetin e të Dërguarit a.s..

Kur'ani është burimi kryesor i komunikimit dhe perceptimet. Suneti i të Dërguarit a.s., i marrë nga veprat e tij dhe gjykimeve, është standardi i sjelljes së bashku me mësimet kuranore, haditheve janë rekord autoritar i thënieve të tij. Hadithi u bë thelbësor për organizimin e informacionit dhe diskursi intelektual në shoqërinë Islame.⁴

Qenësore në mësimet islame janë të drejtat themelore të komunikimit, duke përfshirë të drejtat për të ditur, për të lexuar, për të shkruar dhe për t'u shprehur (komunikuar). Nocioni i el-ilm (njohuri), mbizotëron në të gjithë mësimet kur'anore si parim themelor i gjithë vlerës dhe etikës së komunikimit në Islam. Fjala 'Ikre"(lexim) është ajet (fjalë) i parë që iu shpall të dërguarit të fundit, Muhamedit a.s. Kjo fjalë (ajet) në mënyrë direkte përçon idenë e ndërgjegjshme për të komunikuar brenda komunitetit apo rrethit mysliman.

Patjetër që duhet të jemi të kujdesshëm lidhur me fjalët që përdorim derisa shqyrtojmë marrëdhëniet Islam-Perëndim. Fjalët që duhet

vënë në dukje një të vërtetë, nganjëherë mund të bëhen pengesa më e madhe në të kuptuarit e asaj të vërtete. Fjalët Islam dhe Perëndim shprehin shumë elemente; nga historia te feja, nga kultura tek arti, nga filozofia te shkenca dhe politika. Sot, kur thuhet Islam, në mendjen e njerëzve marrin formë imazhe të caktuara: Meka, njerëz që falen, sulmet vetëvrasëse, gratë të mbuluara etj. Edhe kur themi Perëndim, na faniten shumë imazhe në kokë: qytete të zhvilluara e të populluara, teknologjia, ndërhyrjet ushtarake, video-klipet muzikore, kishat, rrënim i familjes etj.⁵

Mësimi përmendësh (hivzi) Kur'anit është një akt i përbashkët i informacionit dhe komunikimit që ka një histori të gjatë në shoqëritë islame, ajo është ende praktikohet gjerësisht në të gjitha vendet myslimane, duke shërbyer si një lidhje stabile midis mënyrave komunikuese dhe të shkruara. Fakti se arabishtja u bë gjuha kryesore e Islamit, ka ndihmuar transmetimin efikas të ideve (mesazheve), vlerave dhe ahlakut në gjithë botën islame dhe më gjerë. Me një fe të vetme dhe një gjuhë të vetme, komunikimi u shndërrua në një instrument për integrimin e Ummetit (El Ummeh).

Para epokës moderne, qendrat kryesore të komunikimit në botën islame ishin xhamitë, sidomos gjatë ditëve të mëdha dhe festive javore-të premtëve (el xhumua), shesheve publike, si dhe shkollat (medresetë, mejtepet). Institucioni i xhamisë ka shërbyer, jo vetëm për lutjet e përditshme, por edhe për përhapjen e vlerave morale dhe etikës së lajmeve dhe të opinionit dhe si një forum për vendimmarrjen politike, sociale, ushtarake etj. Kjo formë e komunikimit, si predikim (el hutbe) u bazua kryesisht në traditën islame të kombinuar në diskursin fetar.

⁴ Movlana, Hamid and Joseph A. Kéchichian. "Communications Media." In *The Oxford Encyclopedia of the Islamic World*. Oxford Islamic Studies Online, <http://www.oxfordislamicstudies.com/article/opr/t236/e0157>

⁵ Ibrahim Kallën, Islami dhe Perëndimi, Logos-A, 2011.f.25

Etika profesionale dhe teoritë normative

Një koncept i rëndësishëm në fushën e komunikimit islam është termi “teblig”, nocioni i transmetimit dhe përhapja e besimit dhe praktikave islame. Ky nocion, i rrënjësuar në traditat gojore dhe sociale të komunitetit të madh islam, i themeluar një kornizë të etikës të lidhura me komunikimin dhe ndërveprime sociale.

Format e ndryshme të etikës së medias masive që kanë të bëjnë me të drejtat, përgjegjësitë, lirinë dhe rregullimin e shtypit kanë qenë të debatuar në kulturat evropiane që nga futja e shtypit në shekujt 15 dhe në fillim të shekullit të 16-të. Shumica e këtyre debateve u përqendruan në dy fusha: etika profesionale që lidhet me trajnimin e profesionistëve të medias dhe teoritë normative filozofike të komunikimit publik, të cilat mbajnë obligime profesionale të praktikantëve të medias.

Teknologjitë e reja të informacionit të kohës sonë kanë rritur jashtëzakonisht fuqinë dhe funksionin e medias masive, dhe në të njëjtën kohë kanë vënë presion të madh mbi shkencëtarët e medias që të mendonin për të ripërcaktuar parametrat e etikës për gazetarët dhe praktikuesit e medias. Nga njëra anë, këto teknologji të reja kanë demokratizuar procesin e komunikimit, duke inkurajuar komunikimin mes individëve dhe në anën tjetër, ata gjithashtu ofrojnë mundësi për të pasur edhe elita që monopolizojnë informacionin dhe manipulojnë atë dhe kështu të kontrollojnë fatet e të tjerëve, pa pëlqimin e tyre apo edhe kundër vullnetit të tyre. Kjo, si një shënim i shquar i komunikimit sipas Everett ROGERS, është një pikë kthese epistemologjike e analizës së medias dhe të teknologjive të reja të komunikimit, të cilat janë forca lëvizëse prapa këtij revolucioni.⁶

Nuk është e mundur që tensioni mes forcave të tregut të lirë të ideve dhe atyre që avokojnë sjellje të përgjegjshme të praktikantëve të

medieve është duke shkuar në drejtim të zgjidhjes. Ka dy arsye kryesore: për shkak se forcat në vendin e tregut të lirë të ideve dominojnë ekonominë dhe rrjedhimisht strukturat politike, dhe për shkak se ata të cilët avokojnë për sjellje të përgjegjshme të gazetarëve përbëjnë një minoritet dhe nuk kanë asnjë ose vetëm një rol të parëndësishëm në procesin e vendimmarrjes që kanë të bëjnë me menaxhimin e medias dhe të pronësisë. Ata, sipas John C. Merrill, janë akademikë “fosilë” dhe janë një specie e rrezikuar e vetvetes së tyre.⁷ Merrill ka ndarë kodet e etikës ekzistuese të medias dhe përgjegjësisë në tri lloje: ajo që është definuar ose përcaktuar ligjërisht nga qeveritë, që është e definuar në mënyrë profesionale ose e përcaktuar nga vetë shtypi dhe që është e definuar në mënyrë pluraliste ose janë përcaktuar nga vetë gazetarët.⁸

Po shtu Merrill vëren si teori të tretë si i vetmi që është i vlefshëm, kuptimplotë dhe në harmoni me vlerat dhe synimet e shoqërive perëndimore, sidomos shoqërisë amerikane⁹.

Në përpjekjen për të krahasuar kodet ekzistuese të etikës, Thomas V. Cooper ka dhënë një kontekst kombëtar, konceptual, historik dhe gjuhësor. Vendosija e këtyre kodeve brenda një spektri të theksit, Cooper ka ilustruar disa nga polaritetet më të rëndësishme me të cilën shumica e kodeve mund të shpjegohen nga “joformale”, “formale”, “minimale”, “ideale”, “materiale”, “metafizike”, “inhibitive”, “frymëzuese” etj..¹⁰

Ndërsa padyshim nuk ka asnjë përpjekje, nga studiuesit perëndimorë, të krahasojnë këto kode brenda kornizës islame. Jean Claude Bertrand ka vërejtur se Perëndimi është më shumë i shqetësuar me çë-

⁷ John C. Merrill, 'Three Theories of Press Responsibility and Advantages of Pluralistic Individualism,' in Deni Elliott (ed.) *Responsible Journalism*. Beverly Hills, California: Sage, 1986: 56.

⁸ Ibid.: 49.

⁹ Ibid.

¹⁰ Thomas W. Cooper, op. cit.: 236-237, 240.

⁶ Everette M. Rogers. *Communication Technology: The New Media in Society*. New York: The Free Press, 1986:194, 211.

shtjet etike në kontekstin e një “shtypi të lirë”, dhe pjesa tjetër e botës është më i interesuar në çështjet e lidhura rreth drejtësisë.¹¹

Herbert Altschull ka përdorur kategoritë e lirshme të vendeve të orientuara drejt tregut, filozofisë marksiste dhe popujve të përparuar, si dhe ka përshkruar artikujt e besimit që formojnë bazën e kodeve etike të medieeve.¹²

Nuk mund të jetë në kontekste të shumta dhe pajisje metodologjike nga kodet e të cilave mund të klasifikohen. Megjithatë, duke kërkuar në tri perspektiva të diskutuara në këtë artikull, (John C. Merrill, Thomas Cooper, dhe Herbert Altschull) mund të konkludojmë se kombet më të perëndimizuara, duke përfshirë kombet e sapoçliruara të Evropës Lindore, gjithnjë e më shumë janë të prira drejt një teorie të bazuar në treg, të përgjegjësisë në masmedia, e cila është në fakt një teori e pluralizmit individual. Apo thënë në terma më të qarta: Kodi i etikës është ajo që një gazetar, individ apo një institucion i veçantë medial apo një shoqëri e veçantë gjykon të përshtatshme për të mirën materiale të gazetarit, shtypit apo shoqërisë si një tërësi. Kështu, kuptimi dhe vlerat e caktuara për koncepte të tilla si lajme, besnikëri, objektivitet, liri, të drejtën e njerëzve për të ditur dhe fakte mund të ndryshojë sipas rrethanave të veçanta ose në përputhje me nevojat dhe prioritetet e një shoqërie të caktuar në një kohë të caktuar.

Kjo është më se një mund të merreni me rishikimin e literaturës ekzistuese mbi etikën e medias nga tezat e shkencëtarëve perëndimorë për këtë çështje. Kodet e etikës individuale mund të ndryshojnë nga një komb vetëm në lidhje me prioritetet kombëtare, pengesat gjuhësore, diversitetit kulturor apo llojit të strukturës politike.

Pavarësisht përpjekjeve për të hartuar një kod të etikës të pajtuar ndërkombëtarisht, në aspektin praktik ekzistojnë kode të ndryshme të etikës gazetareske në shumë vende të Lindjes, në Perëndim, në Veri dhe në Jug. Procesi i komunikimit masiv është diktuar nga vizioni i një gazetari, se çfarë mund të jetë më e gatshme të shitet për publikun

¹¹ Claude-Jean Bertrand, 'Ethics in International Communication,' *Intermedia*, v.13 (#2), March 1985: 9.

¹² J. Herbert Altschull. *Agents of Power*. New York: Longman, 1984: 26.

më e errët. Lufta për marrjen e Jerusalemit dhe përpjekjet pasuese të sundimtarëve të ndryshëm myslimanë për të rimarrë atë nuk ishin ngjyrosur nga religjioni. Ishte po ky religjion një nga disa arsytet për luftë. Lënia jashtë e këtyre faktorëve të tjerë redukton kryqëzatat në një dimension. Po, besimi ishte jetësor – të paktën për kalorësit e krishterë. Nga ajo që mund të themi shumë shekuj më parë, ata ishin shtyrë nga devotshmëria, të cilën e kishte hedhur Papa Urabni, por nuk e kishte krijuar. Ata besonin se lufta për të çliruar Jerusalemin do të shërbente si një pendesë për mëkatet e tyre dhe do të çonte drejt shpërblimeve në Ahiret. Ata ishin joshur nga një premtim i fuqishëm i shpërblimeve materiale dhe shpirtërore, dhe ata kishin lëvizur nga imazhi i qytetit ku Krishti përfundoi pasionin e tij duke qenë i okupuar nga njerëz, të cilët kishin pak respekt për atë trashëgimi të bekuar. Por, madje edhe këtu, tërbimi i kryqtarëve drejtohej lehtë jo vetëm kundër myslimanëve, por gjithashtu kundër hebrejve apo të krishterëve të tjerë, të cilët nuk e shihnin universin në mënyrën e njëjtë. Konflikti midis besimeve ishte një nga shumë konfliktet, dhe jo gjithmonë ai më i rëndësishmi.

Rivalitetet dhe antagonizmat ndër-myslimane ishin pasqyruar nga ndarjet e ngjashme midis kryqtarëve dhe midis kryqtarëve katolikë, të cilët të paktën formalisht pasonin urdhrat e papës në Romë dhe të Ritit lindor Bizantin, të cilit kishin institucionin e tyre klerikal dhe refuzonin të njihnin autoritetin suprem të papës. Duke ardhur në kufijtë e Perandorisë Bizantine, kryqtarët pritën të pritëshin ngrohtësisht nga perandori Alexius Komnenusi, dhe të mirëpritëshin si aleatë në luftën kundër të pafeve. Kjo ndodhi pavarësisht se Kishat Lindore dhe Perëndimore u ndanë më 1054, kur i dërguari papnor në Kostandinopojë shkishëroi patriarkun për herezi në Kishën e Aja Sofias, e cila ishte ekuivalente të lindorët me Bazilikën e Shën Pjetrit në Romë. Bizantinët nuk e vlerësuan fyerjen publike të babait të kishës së tyre, dhe nëse dikush me zë të lartë do të kishte ofenduar papën në Shën Pjetër, reagimi do të ishte i njëjtë. Ndër arsytet për ndarje, kisha bizantine refuzoi të pranojë shtimin e Romës në besimin e Nicenës të fjalës *filioque*, e cila ka kuptimin se Shpirti i Shenjtë rrjedh nga Babai dhe Djali,

dhe jo, siç besonte Kisha Lindore nga vetëm Zoti Baba. Ishte edhe çështja delikate dhe e zjarrtë e përdorimit të vargut për tharmin e bukës në liturgji. Këto çështje mjaftuan për të shkaktuar ndarjen.

Në dekadat para Kryqëzatës së Parë, të dy kishat ishin përpjekur të shëronin plagën. Si rezultat, në fund të shekullit XI, princërit e Evropës e shihnin Bizantin si një mik natyral në luftën kundër të pafeve, dhe ishin të prirë të shpërfillnin hendekun që ishte hapur midis institucioneve religjioze katolike dhe ortodokse.

Bizantinët ishin skeptikë. Alexiusi, trashëgimtari i një tradite të pasur dhe të sofistikuar, kuptoi se Jerusalemi nuk ishte shkak i mjaftueshëm në bashkimin e interesave të tij me kryqtarët. Ai ishte njeri mendjemprehtë, i ditur dhe pragmatik, i cili gjithashtu është nderuar me një biografi të favorshme nga vajza e tij. Kur hipi në fron, perandoria ishte në rrëmujë dhe kishte nevojë për lidërsip. Turqit ishin vetëm një nga disa kërcënimet dhe Alexiusi duhej të zmbrapste fiset sllave e serbe që po vinin nga Ballkani verior, si dhe venedikasit e normanët grabitqarë. Sistemi i taksave ishte në rrëmujë; ushtria kishte mungesa dhe ishte e copëtuar, ndërsa gjykata e pallatet e Kostandinopojës mbetën madhështore si gjithmonë. Kishte një ndjenjë dëshpëruese se fundi do të ishte afër.

Alexiusi ndryshoi rrjedhjen. Ai grumbulloi ushtrinë, emëroi guvernatorë të aftë, rimbushi thesarin, dhe kërkoi mercenarë në Perëndim, veçanërisht normanë. Ai kishte luftuar princërit normanë në Sicili dhe në Ballkan. Prandaj, e dinte se ata shquheshin në luftime dhe acaroheshin të sundoheshin, por ishte i gatshëm të merrte rrezikun e punësimi të tyre në këmbim të shpërblimit për përdorimin e tyre. Në mënyrë të ngjashme, ai synonte të përdorte kryqtarët për t'u liruar nga sundimi i selxhukëve në Azinë e Vogël, por duhej të sigurohej se ata nuk do të mbanin territoret që do të pushtonin. Përveç kësaj, ushtritë e tyre nuk ishin nën komandën e tij, dhe kur kishin nevojë për ushqime e furnizime, ata kishin prirje të plaçkitnin. Alexiusi ishte përballur me një sfidë që një njeri me aftësi më të vogla nuk do ta përballonte. Ai dëshironte të shfrytëzonte kryqtarët për qëllime të tij, duke mos lejuar t'ia rrezikonin territoret. Si çmim për ndihmën e tij, ai kërkoi që pri-

ncërit të betoheshin se nëse pushtonin ndonjë territor që më parë ishte sunduar nga Kostandinopoja, do t'i kthenin atij.

Humnera kulturore midis Bizantit dhe kryqtarëve mund të kishte qenë më e thellë. Shkëlqimi bizantin ishte zbehur, por vazhdonte të shndriste më shumë se çdo gjë tjetër në Evropë. Bizantinët krenarë i shihnin kryqtarët si fshatarë injorantë, megjithëse të armatosur mirë dhe të devotshëm. Derisa disa kronistë i quanin bizantinët “grekë” për shkak të gjuhës që flisnin, bizantinët e quanin veten “romakë”, pasi e shihnin veten, me justifikim, si trashëgimtarë të perandorisë që ishte krijuar një milenium në parë nga Augustusi. Derisa kryqtarët ishin gjithashtu pasardhës të romakëve, ata qëmoti kishin humbur lidhjet me diturinë e kulturën romake, aq shumë sa ishin të varur nga myslimanët e Spanjës për urtësinë e antikitetit. Myslimanët u referoheshin kryqtarëve si “frankë”, pasi shumica prej tyre, duke përfshirë normanët, ishin nga tokat frënge të sunduara dikur nga Charlemagne. Bizantinët, megjithatë, i referoheshin kryqtarëve si “barbarë”, që ishte ajo që grekët antikë i quanin fiset e pakulturuara e të pacivilizuara të Evropës Qendrore.

Kryqtarët ishin një kuriozitet për bizantinët, dhe vajza e perandorit Anna Comnena shkroi përshtypjet për ta me sy kritikë e të mahnitur të një antropologe rreth një fisi primitiv. Ajo ishte veçanërisht e habitur nga karakteri dhe fiziku i princit norman Bohemond të Tarantos. Sipas Annas, ai “ishte aq i gjatë sa që kalonte madje njeriun më të gjatë me gati 50 centimetra... Mishi në trupin e tij ishte shumë i bardhë... Flokët e tij ishin ngjyrë kafe të çelët dhe nuk ulej në shpinë sikur barbarët tjerë... Pak magjepsje manifestohej gjithashtu në vetë këtë njeri, por ishte e paqartë nga frika që inspironte rrotull tij”. Përshtypjet e Annës, të shkruara vite pas faktit, ishin padyshim të ndikuara nga fakti se Bohemondi do të bëhej sundimtar i Antiochut dhe një vasal i parehatshëm, shpesh antagonist i perandorit. Kryqtarët e tjerë, si Godfrey i Bouillonit dhe Baldwini i Boulogne, më vonë i Edessas dhe më vonë mbret i Jerusalemit, ishin gjithashtu meritore për përsëkrim, por

Bohemondi dallohej si prototip – kalorës besimtar, jo shumë i civilizuar që po shkonte në Tokën e Shenjtë si luftëtar i Zotit.⁶

Dhe në këtë kohë, kjo ishte e gjitha. Termi “kryqtar” nuk ishte sajuar deri në shekullin XIII, megjithëse mungesa e fjalës nuk do të thoshte mungesë e konceptit. Me gjithë debatet e studiuesve, njerëzit që ishin dërguar për Jerusalem më 1096 e mendonin veten ashtu si i ka quajtur një historian francez “pelegrinë të armatosur”.⁷ Ishte një histori e gjatë dhe e krijuar e pelegrinazhit në Jerusalem, veçanërisht si përndesë për mëkatet, dhe Papa Urbani dhe të dërguarit e tij kishin joshur premtimin e shpërblimit shpirtëror me marrjen e armëve për të rikthyer Tokën e Shenjtë nën kontrollin e krishterë. Këta pelegrinë të armatosur mund të kenë treguar sjellje që morali jonë bashkëkohor mund t'i dënojë si brutalë dhe barbarë, por megjithatë sado makutë dhe grabitqarë të kenë qenë, ata jetuan në një botë me besim të thellë dhe të thjeshtë, që jo vetëm bashkëjetoi me mëkatet e trupit, por shpesh ishte nxitur nga ta. Kryqtarët e dinin se ata kishin bërë mëkate të vogla e të parëndësishme, dhe kjo e bëri aktin e pelegrinazhit shumë më të rëndësishëm.

Derisa rëra lëvizëse e politikës së Lindjes së Afërt tekefundit ishte një dhuratë për kryqtarët, fati i Peterit të Hermitit dhe pasuesve të tij, të cilët ishin dërguar së pari, iu siguroi ndihmë shtesë të papritur. Shfaqja e Peterit me një ushtri, për arsye të madhësisë absolute, kishte menaxhuar të masakronte çifutët dhe disa qyteteve përgjatë Danubit, por kjo nuk kishte krahasim për selxhukët. Alexiusi dhe pallati i tij ishin tmerruar nga fëlliqësia dhe kaosi i turmës së Peterit, dhe perandori u siguroi që “ushtria” fshatare të transportohej shpejt përgjatë Bosforit dhe larg nga qyteti. Posa arritën në anën aziatike, ata u ndanë në

⁶ Anna Comnena është burimi primar për Alexius. Burimet sekondare të mira përfshijnë John Julius Norwich, *Byzantium: The Decline and Fall* (New York: Knopf, 1995), 31-35; Ostrogorsky, *History of the Byzantine State*, 349-70. Anna Comnena për Bohemondin është cituar në Elizabeth Hallam, ed., *Chronicles of the Crusades: Eye-Witness Accounts of the Wars Between Christianity and Islam* (New York: Welcome Rain, 2000), 69-70.

⁷ Për frazën “pelegrinë të armatosur”, shih Goerges Bordonove, *Les Croisades et le royaume de Jerusalem* (Paris: Editions Pygmalion, 2002).

copa nga sulltani lokal, i cili natyrisht i mori ata si përfaqësues të asaj që frankët mund të ofronin. Kur ushtritë më të disiplinuar dhe më të pajisura të normanëve dhe kalorësve të tjerë arritën më vonë, emiri selxhuk gabimisht supozoi se ata ishin shumë të njëjtë.

Seluxhukët lokalë mund të mos i kishin marrë kryqtarët seriozisht, por Alexiusi e bëri. Duke i bindur shumicën e tyre që të betoheshin për besnikëri, ai i shoqëroi jashtë qytetit dhe përgjatë Bosforit në Azi. Ata morën Nicean (që njihet si Iznik në turqisht) në maj 1097 dhe pastaj avancuan drejt jugut në të njëjtin shteg që kishte mirëpritur Xerxesin dhe Aleksandrin në shekujt e kaluar. Shtegu i ngushtë Cilician midis maleve të Anadollisë jugore që ndan Azinë e Vogël nga Siria, dhe përmes saj, kryqtarët rrethuan qytetin antik të Antiochut. Deri në pushtimin e tij nga selxhukët më 1085, Antiochu ishte një nga qytetet më të rëndësishme të krishtera në botë, së bashku me Jerusalemin, Kostandinopojën dhe Romën.

Pas një rrethimi të lodhshëm tetëmuajsh, Antiochu ra në duart e kryqtarëve në qershor 1098. Detyra ishte bërë më e lehtë nga grindjet që ndanin fraksionet arabe dhe turke që po përpiqeshin të mbronin muret e frikshme të qytetit. Antiochu ishte gjithashtu shtëpi për një popullatë të madhe të krishterë që kishte jetuar aty që nga shekulli I, dhe kur kryqtarët arritën te portat, guvernatori turk i dëboi. “Antiochu është i juaji”, u tha atyre, “por duhet të ma lini mua derisa të shoh se çka do të ndodhë mes nesh dhe frankëve”. Ai premtoi se do të kujdesej për gratë dhe fëmijët e tyre, por nuk i lejoi ata të kthehen. Këto dëbime morën pritje të ftohtë nga frankët. Kryesisht ortodoksë grekë dhe armenë, ata flisnin gjuhë të ndryshme dhe adhuronin me rite të ndryshme, dhe frankët i trajtonin me dyshim dhe përbuzje. Ndjenjat ishin reciproke, dhe të krishterët krenarë të Antiochut, prejardhja e të cilëve shkon te Shën Pjetri, u ndjenë më pak besnikë ndaj kryqtarëve sesa arabët dhe turqit, me të cilët kishin jetuar, kryesisht në paqe, gjatë shekujve të kaluar. Megjithatë kishin shërbyer si agjentë të dobishëm të inteligjencës për Bohemondin dhe komandantët e tjerë, ata nuk i besuan motivet e pushtuesve.

Antiochi më në fund u dorëzua pasi që kryqtarët u ndihmuan nga një gjeneral turk i çmagjepsur me fraksionin lokal. Bohemondi pastaj lejoi ushtarët e tij, të cilët kishin vuajtur gjatë muajve të gjatë, të shkatërronin dikur qytetin e madh. Dhe si në qytetet tjera përgjatë rrugës në Jerusalemin, kryqtarët nuk ndaluan të pyesnin nëse shtëpia që kishin plaçkitur ishte e të krishterëve, apo nëse gratë që kishin përdhunuar recitonin Besimin Nicene apo vargjet hapëse të Kur'anit.⁸

Pas disa ditë grabitjeje pa dallim, princërit ngadalësuan ushtrinë e tyre. Trajtimi i bërë në Antioch dukej ekstrem në atë kohë, por nuk ishte jashtë standardit për luftën frënge dhe gjermane, e as nuk krahasohet me atë që ishte përgatitur për Jerusalemin. Hipokrizia e Bohemondit tronditi myslimanët dhe bizantinët, por nuk kishte ngritur vetullat në Evropës. Ai nuk zbatoi premtimin e tij dhënë Alexiusit për ta kthyer Antiochin nën kontrollin bizantin dhe në vend të kësaj shpalli veten mbret të saj. Kjo armiqësoi jo vetëm perandorin, por edhe kalorësit miq të Bohemondit. Njëri nga ta, Baldwini, u drejtua në lindje me ushtrinë e tij pas shpërthimit të xhelozisë dhe mori qytetin e Edessas. Forcat e mbetura, tani mjaft të shterura, vazhduan në jug.

Rrethimi dhe pushtimi i Antiochut zgjoi princërit selxhukë, si dhe kalifin fatimit në Kajro, për të qenë të vëmendshëm. Një kronist mysliman i shekullit XX përshkoi më vonë fitoren e krishterë në Antioch si kulminacion të viteve të agresionit kundër Islamit që ka filluar me rënien e Toledos në Spanjë në duart e të krishterëve më 1071, dhe pastaj vazhdoi me invadimin norman të Sicilisë, të udhëhequr nga të afërmit e Baldwinit të Edessas. Modeli, të paktën sipas një historiani mysliman, ishte i qartë: Të krishterët kanë zhvilluar një luftë ndërko-

⁸ Shih kronikat e Ibn al-Athirit, të cituar në Francesco Gabrielli, *Arab Historians of the Crusades* (Berkeley: University of California Press, 1969), 3-9; Ibn al-Qalanisi, *The Damascus Chronicle of the Crusades*, ed. and trans. H. A. R. Gibb (New York: Dover Publications, 1932, 2002), 43-46. Shih gjithashtu historinë autoritare të Steven Runciman, *A History of the Crusades*, vol. 1, *The First Crusades and the Foundation of the Kingdom of Jerusalem* (Cambridge: Cambridge University Press, 1951), 213ff.

mbëtare për të kthyer avancimet e myslimanëve, dhe sulmet kundër Atiochut, Edessas, dhe Sirisë ishin të fundit në një seri.⁹

Por, madje edhe pas Antiochut, jo të gjitha elitat arabe dhe turke të Lindjes së Afërme i morën kryqtarët seriozisht. Kjo do të ndryshonte përgjithmonë me rënien e Jerusalemit më 1099. Krahason me rrethimin tetëmuajsh të Antiochut, Jerusalemi ishte marrë më lehtë, në më pak se dy muaj. Por, derisa kryqtarët kishin kampuar nën muret e Antiochut kryesisht gjatë dimrit dhe pranverës, lufta për Jerusalem ishte zhvilluar gjatë zhegut përcëllues të verës. Pas më shumë se tre vjet të luftës gati të vazhdueshme në territore të panjohura, kryqtarët u rrasë kapitën dhe ishin të shqetësuar për fundin e misionit të tyre. Ndoshta kjo shpjegon atë që ndodhi kur muret më në fund u çanë.

Siç kishte qenë për shekuj, Jerusalemi ishte i banuar atëherë nga një përzjerja e çifutëve, të krishterëve dhe myslimanët. Lagjet çifute kishin ekzistuar që nga koha para Krishtit, dhe sektet kryesore të krishtera kishin nga një pjesë të qytetit dhe disa përgjegjësi për mirëmbajtjen e vendeve të shenjta përgjatë Via Dolorosa. Por, mbrojtja e qytetit ishte nën kontrollin e guvernatorit fatimit dhe ai e shihte popullatën lokale të krishterë dhe çifute si një shtyllë të pestë të mundshme. Ai mori një vendim solominik: të krishterët i largoi jashtë qytetit, ndërkaq hebrenjtë i lejoi të qëndrojnë. Shumica e të krishterëve ikën, me përjashtim të rojeve të Varrit të Shenjtë, i cili nuk ishte rindërtuar plotësisht që nga përdhosja e Hakimit.

Rrethimi ishte i hapur, dhe në mes të korrikut 1099, ushtarët e Godfrey të Bouillonit, me anë të kullave të frikshme, deshve të rëndë, dhe forcës së kafshëve, çanë muret. Disa nga të krishterët e qytetit ndihmuan sulmuesit, pasi guvernatori fatimit i kishte frikësuar. Ata ndoshta kishin shpresuar se ushtritë fitimtare do t'i shpërblenin për ndihmën e tyre. Po ta dinin se çka do të ndodhte në të vërtetë, do të kishin luftuar deri në njeriun e fundit për të penguar kryqtarët nga pushimi i qytetit.

⁹ Historianë, Ibn al-Athir, është cituar gjatë në P. M. Holt, *The Crusader States and Their Neighbors* (New York: Longman, 2004), 18.

Kronistët myslimanë të rënies së Jerusalemit kanë përshkruar mizoritë e zakonshme, por ajo që e dallon Jerusalemin në analet e pushimeve të gjakftohta është se kronistët e krishterë ishin njësoj të tronditur me atë që kishte ndodhur. Kryqtarët kishin udhëtuar për një qëllim bishtnues, dhe posa e kishin arritur, kishte shpërthyer zemërimi i tyre. Cilado qoftë arsyeja, qyteti jo vetëm që ishte grabitur; ai ishte përdhosur dhe banorët e tij ishin masakruar.

Pavarësisht përpjekjeve të pavlera të Godfreyit dhe gjeneralit tjetër të krishterë, Tancredit, për t'u përmbajtur, ushtarët e tyre u shpërndanë në gjithë qytetin dhe vranë çdonjërin që gjetën. Masakra nuk ishte e kufizuar te myslimanët arabë dhe turq. Hebrenjtë e qytetit u strehuan në sinagogat e tyre vetëm duke u mbyllur dhe u dogjën të gjallë. Murgjit ortodoksë të Lindjes u përpoqën të parandalonin grabitjen e Varrit të Shenjtë nga ushtarët, të cilët ishin më të interesuar për prene sesa për bekimet. Ata vranë secilin që i dilte para. Ka pasur histori të foshnjave që janë përplasur për gurë, të torturave që kanë zgjatuar për ditë me qëllim të argëtimit të trupave, të prerjes së kokave, kryqëzimit, heqjes së lëkurës, gjymtimit dhe kufomave kudo; dhe herë-herë, përgje të kufomave të mbledhura, gati artistikisht, nga pellgjet e gjakut.¹⁰

Jeto dhe lejo të jetojnë

Rënia e Jerusalemit tronditi thellë botën myslimane. Myslimanët nderuan qytetin, dhe brutaliteti i pushtuesve të tij nga të krishterët ishte një plagë që kurrë nuk do të shërohej plotësisht. Trajtimi që iu bë banorëve të pafat nuk ishte i pazakontë për standardet e asaj kohe. Por, fakti se ndodhi në Jerusalem, një qytet shumë i respektuar, ishte shqetësues dhe jo vetëm për myslimanët. Mëngjesi proverbial, madje edhe kryqtarët ishin të turpëruar me atë që kishte ndodhur, duke gjy-

¹⁰ Shih Runciman, 279ff.; Hallam, *Chronicles of the Crusades*, 88-94; Hans Eberhard Meyer, *The Crusades* (New York: Oxford University Press, 1965, 1988), 54-57; Asbridge, *The First Crusaders*, 316-19; Amin Maalouf, *The Crusades Through Arab Eyes* (New York: Schocken Books, 1983, 1987), 48-52.

kuar nga kronistët e krishterë të pushtimit të qytetit. Masakrimi i myslimanëve, të cilët ishin strehuar në xhaminë Al Aksa mund të ishte pak e pranueshme, por vrasja e krishterëve të ritit lindor në faltoren e Varrit të Shenjtë nuk ishte e tillë.

Në kohë, rënia e Jerusalemit u bë çarja ngacmuese për myslimanët e Lindjes së Afërt, por menjëherë më pas, zemërimi nuk u plotësua me veprim. Poetët shkruan vajtime rreth asaj që kishte ndodhur, dhe disa bënë thirrje për një fushatë për të zmbrapsur invadimin e krishterë. Këto nuk patën efekt. Emirët turq të Damaskut dhe Alepit ishin shumë të dobët, shumë antagonistë me fatimitët, shumë të dyshimtë për sundimtarët e Mosulit dhe Irakut, dhe shumë rivalë me njëri-tjetrin për të formuar një aleancë të aftë për të sfiduar frankët. Thirrjet për unitet të myslimanëve përballë inkursionit të huaj nuk ishin mjaft bindëse për të tejkaluar ndarjet politike, kulturore dhe teologjike midis fraksioneve të ndryshme që kontrollonin Lindjen e Afërt. “Sulltanët nuk u pajtuan mes vete”, shkroi historiani arab Ibn al-Athiri, “dhe kjo ishte arsyeja që frankët arritën të merrnin kontrollin e vendit”.¹¹

Është joshëse të identifikohen kryqtarët si kapituj dramatikë në luftën midis Islamit dhe Perëndimit, veçanërisht duke pasur parasysh mënyrën sesi Jerusalemi ra më 1099. Dhe kjo joshje është përkrahur nga ajo që ndodhi pas Kryqëzatës së Parë. Derisa po kalonte shekulli XII, u bë e zakonshme të shihen kryqtarët si një degëzim i një fushate ndërkombëtare të drejtuar nga të krishterët perëndimorë kundër myslimanëve. Si studiuesit e krishterët, edhe ata myslimanë, duke filluar shekuj më parë dhe duke përfunduar në shekullin XIX, mbledhën betejë të ndryshme, të zhvilluara nga fraksione të ndryshme mijëra milje larg, nën flamurin e luftës religjioze. Polemistët e kohës, myslimanë e të krishterë, kishin gjithashtu arsye të mirë për të krijuar këtë strukturë.

Ende qëndron fakti se në atë kohë, lufta e shenjtë nuk tërhoqi mjaftueshëm përgjigjen e sundimtarëve apo njerëzve të Lindjes së Afërt për të funksionuar si një klithmë protestuese efektive. Tendenca e

mëvonshme në Perëndim dhe në botën myslimane për t'u fokusuar në kryqëzata si luftëra midis religjioneve e bënë të duket sikur religjioni të ishte faktori i vetëm, por në të vërtetë, ai ishte vetëm një faktor, rëndësia e të cilit rritej dhe pakësohej paparashikueshëm. Thjesht: nëse luftërat midis religjioneve do të kishin një rëndësi kaq thelbësore, atëherë kryqtarët kudo në Evropë do të kishin nxituar për të luftuar krah për krah me vëllezërit e tyre bizantinë, dhe myslimanët do të kishin tejkaluar ndarjet e tyre dhe do të ishin bashkuar për të luftuar armikun e përbashkët. Kjo nuk ndodhi.

Në vend të kësaj, Kryqëzata e Parë u udhëhoq kryesisht nga kalorësit frankë, dhe pastaj frankët – në vend se të zhvillonin një luftë të përhershme kundër myslimanëve – u bënë pjesë e strukturës politike të Lindjes së Afërt. Fitorja më 1099 çoi në rritjen dramatike të numrit të pelegrinëve në Jerusalemin, si dhe një mini-emigrim të kolonëve. Megjithatë numri i saktë është e pamundur të dihet, duket se dhjetëra mijëra persona nga Evropa Perëndimore dhe Qendrore imigruan në mbretëritë e reja të Jerusalemit dhe Edessas. Disa nga këta ishin fisnikë të vegjël që kërkonin një fillim të ri; të tjerët ishin zejtarë, ushtarë apo fshatarë të sjellë nga zotërinjtë e tyre apo të joshur nga tokat e reja. Të tjerët ishin tregtarë nga Gjenova, Piza, Venecia apo Amalfi, të cilët u vendosën në portet bregdetare si Akra, Tyre dhe Jaffa. Italianët, me anijet e tyre superiore dhe lidhjet e tyre tregtare të gjalla në Mesdhe, morën kontrollin e asaj që ata shpresuan të ishin rrugët fitimprurëse tregtare që shtriheshin në Azinë Qendrore, Indi dhe më tej.

Historitë popullore të kryqëzatave në Perëndim dhe në botën myslimane fokusohen vetëm në konflikt. Madje edhe kronistët bashkëkohorë, duke shkruar për shekujt XII dhe XIII, rrallë i kushtojnë vëmendje jetës së përditshme. Pati një dramë të vogël në këtë, dhe asnjë heroizëm. Fokusimi i papërkulshëm në luftën ka qenë problem i historisë të shkruar në përgjithësi, dhe jo të kufizuar në subjektin e myslimanëve dhe të krishterëve në Lindjen e Afërt. Deri në pjesën e dytë të shekullit XII, disa që shkruan historinë – qofshin myslimanë, të krishterë, hebrenj dhe indusë – humbën kohën në bujqësi, tregti, imigrim, jetën e brendshme, dhe aspektin rutinë të arritjes gjatë ditës.

¹¹ Ibn al-Athir është cituar në Maalouf, 55.

Historia e shkruar ka ekzagjeruar kështu frekuencën dhe pjesën qendrore të luftës, revolucionit, kaosit dhe ndryshimeve në qeverisje. Pasojë e kryqëzatave është se ne kujtojmë luftën, por jo paqen. Për dy shekuj, megjithatë, evropianët perëndimorë jetuan në Lindjen e Afërt, dhe derisa rrallë kalonte një vit pa disa përleshje kundër disa armiqve, ka pasur periudha të gjata të qetësisë.

Historianët bashkëkohorë kanë bërë përpjekje të koncentruara për të mbushur boshllëqet e jetës ditore në Evropë në atë kohë, por përpjekje shumë më të vogla janë bërë në vizatimin e fotos komplete të shoqërive të Lindjes së Afërt nën sundimin e frankëve. Që nga mesi i shekullit XX, dhe me disa kërcënime origjinale, studiuesit e shoqërive mesjetare kanë bashkuar në mënyrë të kualifikuar tapicerinë e ashtuquajtur të Epokës së Errët. Kjo varfërisht është përdorur për të plotësuar konturat e jetës së përditshme në shtetet e kryqtarëve.

Si rezultat, për pjesën më të madhe të 900 vjetëve të kaluara, historitë e kryqëzatave – në Perëndim dhe në botën myslimane – kanë treguar ngjarje të thjeshta të përleshjeve religjioze, të filluara nga papati, të zhvilluara nga kalorësit e Evropës dhe pastaj vazhduan në fund të shekullit XII, me entuziazmin e njëjtë nga myslimanët e Lindjes së Afërt dhe shpëtimtari i tyre, Salahudini. Kjo histori është bërë pjesë e memories kolektive të perëndimorëve dhe myslimanëve. Në Perëndim, brenda disa vjetëve nga krijimi i mbretërisë së Jerusalemit, kjo tashmë iu ishte thënë në Evropë, veçanërisht nga ata që shfrytëzuan Kryqëzatën e Parë, për të krijuar një kishë më të centralizuar dhe shtete më të fuqishme në Evropë. Pastaj, historia vazhdoi në balada dhe poema epike, që synonin të inspironin dhe të argëtonin. Gjatë shekujve, shumë kohë pasi që franku i fundit u dëbua nga Lindja e Afërt, kujtimi depërtoi në kulturën popullore përmes novelave, dramave dhe eventualisht, në shekullin XX, filmave.

Në botën anglishtfolëse, novelat e shekullit XIX të Sir Walter Scottit bënë më shumë se gjithçka tjetër për të krijuar imazhin popullor të kryqëzatave. Duke huazuar mjaft nga Edward Gibboni, Scott lartësoi Salahudinin dhe Richard Zemërluanin si ikona të garës midis Islamit dhe Krishterimit, dhe librat e tij u morën më vonë nga Hollywoodi

si material burimor për filma. Në novelat si “The Talisman and Iva-nhoe”, Scotti e portretizoi Salahudinin si një kundërshtar aristokratik, një luftëtar mysliman që respektoi kodin e nderit aq shumë të dashur nga fisnikët dhe kalorësit e krishterë, Por, Salahudini ishte përjashtim i rregullit që portretizonte “saraçinët”, si kafshë heretike.

Në qendër të historisë popullore ishin urdhrat e kalorësve religjiozë: Templarët dhe Hospitalerët. Templarët, me veshjet e tyre të bardha me një kryq të kuq, u bënë prototip i luftëtarit të krishterë. Të quajtur sipas Tempullit të Solomonit në Jerusalem, ku jetuan, Templarët morën miratimin zyrtar të kishës në fillim të shekullit XII. Tempulli nuk ishte vetëm qendër domethënëse e mbretërisë së parë izraelite në Tokën e Shenjtë, ai ishte gjithashtu vendi ku më vonë myslimanët ndërtuan xhaminë Al Aksa. Si rend religjioz të bekuar nga papa dhe i sponsorizuar nga Bernardi i Clairvauxit, Templarët përfaqësonin bashkimin e ushtarit dhe priftit, dhe fama e pasuria e tyre mbijetuan shumë gjatë pas largimit të tyre nga Toka e Shenjtë. Ata dhe Hospitalerët u tërhoqën përfundimisht në ishujt e Mesdheut si Malta dhe Rodet, derisa otomanët i zëvendësuan. Pas zhdukjes së urdhrat, megjithatë, legjenda u rrit derisa imazhi i Templarëve u ngulit përgjithmonë në vetëdijen perëndimore. Ata u bënë ikona të kryqtarëve. Ata kanë hijeshuar novelat e harruara të Viktorianëve, romancat franceze, filmat hollivudianë, bestsellerët ndërkombëtarë, dhe kanë shërbyer si ogurzi, karakter ndikues të levës së historisë, forcë e fshehtë dhe e errët së bashku me Masonët dhe Iluminati.

Por, derisa urdhrat religjiozë ishin të njohur në shoqërinë franke në Lindjen e Afërt, ata ishin minoritet i vogël, megjithëse i fuqishëm, i të gjithë kolonëve evropianë në Orient dhe ndoshta më pak të rëndësishëm sesa tregtarët italianë, të cilët kontrollonin tregtinë, por nuk bënë luftëra. Madje vlerësimet më zemërgjera sugjerojnë se Templarët dhe Hospitalerët kurrë nuk kanë pasur më shumë se një mijë kalorës të armatosur në një kohë. Një shikim i shpejtë në katalogun e librarisë do të tregojë mijëra shënime të urdhrave të kryqtarëve, që e bënë literaturën të duket e vogël mbi tregtinë. Tregtarët mund të kenë qenë më të rëndësishëm në skemën e madhe të gjërave, por ajo që

bënë ishte më pak detyruese për shkrimtarët dhe polemistët, qoftë në atë kohë apo në shekujt e mëvonshëm. Çka do të bëjë një novelist romantik me një tregtar të ngathët në Akra? Më mirë të fokusohet në kalorësit, kështjellat, luftën dhe njerëzit me thurak të shndritshëm. Për kronistët arabë dhe turq të pallateve, Templarët ishin ikonë perfekte, provë e lakmisë dhe pangopësisë së të krishterëve. Një tregtar i erëzave nga Piza që aranzhonte ngarkesa në Sidon ishte më pak interesant.

Në botën e zakonshme të mbretërive të kryqtarëve në shekullin XII, megjithatë, këta tregtarë, zejtarë dhe fshatarë që tejkalonin në numër Templarët dhe Hospitalerët, ishin të rëndësishëm si vasalë të Romës, por bënë pak për t'i dhënë formë shoqërisë së përditshme në Siri, Liban apo Palestinë. Urdhrat ishin integrale me ambiciet e Papës, por ata ishin vetëm një element në balancimin e fuqisë në Lindjen e Afërt.¹² Historia aktuale e jetës së përditshme gjatë periudhës së kryqëzatzave është më e rëndomtë dhe i mungojnë karakteret dinamikë dhe liderët dominues. Emrat e personave që jetuan dhe vdiqën janë të paqartë, nëse regjistrohen fare. Princërit dhe mbretërit e shteteve franke në Lindjen e Afërt janë mbajtur gjallë nga studiuesit, dhe shumica e betejave përfundimtare janë regjistruar ose nga myslimanë ose nga të krishterë. Por, kjo nuk ka ndodhur me qetësinë e gjatë midis tyre.

Një pjesë e shpjegimit është prozaik: qetësia e bën të mërzitshëm leximin. Deri në fund të shekullit XX, askush nuk ka shkruar novelë për jetën rutinë, apo të bëjë film pa asnjë komplot. Dhe nuk është se periudhat midis luftërave janë më pak dinamike. Gjithashtu, ato e bëjnë historinë më të komplikuar dhe të errët, dhe kështu minojnë historitë bardhezi të konfliktit. As kulturat perëndimore e as ato myslimane nuk kanë dëshiruar fokusimin në bashkëjetesë. Për pjesën më të madhe të shekullit XII në Lindje të Afërt, jeta ditore është formuar jo nga luftëtarët heroikë, por nga qytetet-shtete të vogla të krishterëve perëndimorë me disa fisnikë e burokratë, të cilët ishin të rrethuar nga arab-

ët myslimanë dhe turqit dhe nga fshatarët dhe elitat e krishtera lindore, të cilët kurrë nuk u konvertuan në Islam. Historia e tyre, kryesisht e harruar, nuk është as e lavdishme e as poshtëruese.

Pushtimi i Jerusalemit u pasua nga krijimi i mbretërisë franke të Jerusalemit dhe kurorëzimit të mbretit të saj të parë, Godfrey. Ai vdiq shpejt dhe u pasua nga Baldwini i Edessas, i cili u bë mbreti Baldwin I i Jerusalemit dhe mbeti i tillë deri në vdekjen e tij më 1118. Ushtritë franke vazhduan në bregdetin e Palestinës, sulmuan Tripolin, dhe luftuan Fatimitët dhe Selxhukët. Pas krijimit të shteteve të reja të krishtera, ato rikrijuan feudalizmin e Evropës Perëndimore. Mbretëria e Jerusalemit formalisht sundoi shumë prej qyteteve-shtete të asaj që tani është Izraeli dhe Bregu Perëndimor i Palestinës; zotërinjtë e Anti-ochut pretenduan sovranitetin mbi pjesë të mëdha të asaj që sot është Libani; dhe mbretëria e Edessas përfshinte disa mijëra milje katrorë të banuar kryesisht nga armenët e krishterë.

Princërit frankë sundonin fshatra të rralla të rrethuara me qytete. Shumë myslimanë ikën para dhe pas vitit 1099, pas përhapjes së fjalës për barbarinë e krishterë. Jerusalemi ishte boshatisur gati nga banorët e saj përmes efekteve të kombinuara të luftimeve dhe masakrave, dhe madje një dekadë më vonë, popullsia e qytetit ishte vetëm disa mijëra. Jashtë Jerusalemit, zonat e kontrolluara nga kryqtarët ishin të populluara nga një përzierje e të krishterëve dhe myslimanëve. Shumica e studiuesve pajtohen se Lindja e Afërt edhe në këtë pikë, gati pesëqind vjet më vonë pas pushtimeve arabe, ishte akoma shtëpi e një popullsie të madhe të krishterë, e cila në shumë rajone ishte shumicë. Kjo do të thoshte se kryqtarët gjetën veten duke sunduar shtete me numër të konsiderueshëm të të krishterëve. Pushtuesit, megjithatë, i shihnin me përçmim ata, pasi flisnin një gjuhë të pakuptueshme, kishin mënyra të huaja të organizimit të meshave, dhe mbanin pozita teologjike që shumë kohë më parë ishin deklaruar heretike në Perëndim.

Së pari, frankët trajtuan të krishterë lokalë si persona të pushtuar. Megjithëse pati disa liri të detyrimeve sociale, lokalët mbetën qytetarë të dorës së dytë. Frankët, madje nuk hoqën taksën e pakëndshme që myslimanët e kishin vendosur mbi Ithtarët e Librit. Në vend të kësaj,

¹² Piers Paul Read, *The Templars* (London: Weidenfeld & Nicholson, 1999); Edith Clementine Bramhall, "The Origins of the Temporal Privileges of Crusaders", *American Journal of Theology* (April 1901), 279-92.

ata mbajtën taksën, shtuan myslimanë në lista, dhe vazhduan të takojnë të krishterët dhe hebrenjtë autoktonë. Në esencë, shumica e popullsisë, qofshin të krishterë apo myslimanë, panë se jetët e tyre ndryshuan pak.

Të krishterët lindorë, as nuk u ngritën kundër kryqtarëve e as nuk i pranuan plotësisht ata. Ata iu shërbyen zotërinjve të tyre, ashtu siç i kishin shërbyer të vjetërve, por ata të paktën ndanin besimin bazik në qendër të cilit ishte Krishti me jetët e tyre. Frankët mund të mos kenë respektuar të krishterët lokalë, por të krishterët lokalë gjetën mundësi të reja për përparim shoqëror, kryesisht si ndërmjetës midis myslimanëve të Lindjes së Afërt dhe mbretërive të reja të krishtera.

Veç kësaj, të krishterët lindorë e kishin më të lehtë që të merreshin si mercenarë nga shtetet kryqëtare sesa nga Selxhukët apo Fatimitët. Ndryshe nga Templarët dhe Hospitalerët, të cilët i përgjigjeshin kryesisht vetes dhe formalisht papës, mercenarët e krishterë lindorë i bindeshin urdhrit të princit apo mbretit që i kishte punësuar. Kjo ishte një ujdi e mirë për sundimtarët frankë dhe për popullsinë lokale. Të krishterët maronitë të Malit të Libanit, të cilët ishin afruar edhe më me Romën, përfituan jashtëzakonisht nga krijimi i posteve tregtare përgjatë bregdetit, dhe ata gjetën punësimin fitimprurës si ushtarë të princave të Akras, Sidonit dhe Tripolit. Gjithashtu, ata shërbyen si përkthyes dhe ndërmjetës për tregtarët italianë, të cilët dëshironin qasje në rrugët tregtare të kontrolluara nga selxhukët në lindje të Damaskut dhe Alepit. Trashëgimia e lidhjeve të afërta midis maronitëve dhe frankëve (francezëve) zgjati edhe në shekullin XX dhe kulmoi me krijimin e shtetit modern të Libanit.

Gradualisht, megjithatë, frankët filluan të asimilohen. Ata ndryshuan mënyrën e veshjes, gjuhën që flisnin, dhe madje edhe ata me të cilët martoheshin. Shumica e krushqive ndodhi midis frankëve dhe të krishterëve lokalë; martesat midis të krishterëve dhe myslimanëve nuk miratoheshin nga të dyja palët. Por, burrat e gratë kishin një mënyrë të shmangies së kontroleve sociale. Kalorësit, të cilët kishin ardhur për të luftuar dhe pastaj qëndruan, kishin nevojë për femra. Seksi ishte lehtë të sigurohej, me një çmim apo nga një skllave, por martesat ishin

më sfiduese. Aristokratët mund të aranzhonin martesat për të forcuar aleancat midis shteteve kryqëtare, midis familjeve sunduese franke në Lindjen e Afërt dhe mbretërve bizantinë apo me fisnikërinë në Evropë. Por, për pjesën tjetër, rruga më premtuese ishte ajo më e lehta – gratë nga popullsia lokale. Zakonisht këto ishin të krishtera, por jo gjithmonë.

Rritja e krushqive tërhoqi vëmendjen e kronistit Fulcher të Chartresit. Duke shkruar rreth vitit 1127, ai vuri re se shtetet kryqëtare ishin bërë po aq korruptuese, të parëndësishme dhe të ndara si homologet e tyre në Evropë. “Perëndimorët janë bërë tani orientalë. Ai që ishte romakë apo frankë tani është galilean apo banor i Palestinës... Ne kemi harruar tani vendlindjet tona... Disa tashmë kanë këtu shtëpi apo shërbëtorë, të cilat i kanë marrë përmes trashëgimisë. Disa kanë marrë gra jo thjesht të popullit të vet, por siriane, apo armeniane, apo madje saraçine, të cilat kanë marrë hirin e pagëzimit”.¹³

Si pjesë të procesit të asimilimit, të krishterët perëndimorë në Lindjen e Afërt u bënë më tolerantë ndaj diversitetit religjioz sesa kishin qenë në Evropë. Kur përçmuan ritet e të krishterëve lindorë dhe i trajtuan myslimanët (dhe hebrenjtë) si shpirtra të humbur, ata nuk ia ndërruan fenë e as nuk u përpoqën që jetën këtyre nënshtetasve t’ia bënin të pambrojtur. Pjesërisht, kjo nuk ishte e domosdoshme. Ka pasur numër të madh të krishterëve të sekteve të ndryshme dhe myslimanë, për ndihmën dhe mbështetjen e të cilëve kishin shpesh nevojë. Posa u arrit qëllimi i marrjes së Jerusalemit, frankët u përballën me detyrën e frikshme të krijimit të shteteve të suksesshme, pa masterplan për qeverisjen e tyre. Ata u detyruan të improvizojnë, dhe u përballën me shoqëri më të sofistikuar, të cilat i kishin pushtuar dhe tani i sundonin, ata huazuan shumë.

Shtetet kryqëtare rivalizonin jo vetëm veshjen dhe zakonet e të krishterëve lokalë, por gjithashtu edhe politikën e sundimtarëve myslimanë që i kishin zëvendësuar. Rezultati ishte një kulturë qejfprishur e tolerancës. Sa kohë që taksat paguheshin, shumica e popullsisë lokale

¹³ Cituar në Holt, 45.

u la vetëm, e lirë të impononte zakonet e veta sociale dhe religjioze. Një kronist mysliman, i cili ishte i pakufizuar në armiqësinë e tij ndaj frankëve, megjithatë pranoi se ata nuk binin ndesh me të drejtën e myslimanëve për të adhuruar Zotin ashtu siç dëshironin dhe “nuk ka ndryshuar asnjë ligj të vetëm apo praktikë kulturi”. Gjykatat e ngritura nga frankët, derisa privilegjonin dëshmitë e të krishterëve, siguronin mbrojtje për myslimanët si qenie njerëzore “sikur frankët”.

Sundimtarët e rinj të Jerusalemit e shndërruan xhaminë Al Aksa në kishë, me një manastir për Templarët. Gjithashtu, ata ndanë një hapësirë për myslimanët për t’u lutur. Është kuptuar se kur qendrat kryesore pushtoheshin nga të krishterët apo myslimanët, kisha apo xhamia kryesore në mënyrë simbolike do të ndryshohej për të reflektuar religjionin e sundimtarëve. Si rezultat, nuk pati asnjë thirrje jomyslimane kur Al Aksaja u transformua në kishë. Duke ditur imazhin e kryqtarëve si një periudhë e pazbatuar e luftës së shenjtë, mungesa e mizorisë është e vështirë të bashkërendohet. Një ngjarje e ngjashme në Jerusalem sot do të zhyste rajonin në kaos.

Në pjesën e parë të shekullit XII, megjithatë, nuk pati kulturë të rrënjësuar të luftës religjioze në Lindjen e Afërt. Ishte po aq e zakonshme për frankët të luftonin frankët apo bizantinët sikur që ishte për frankët të luftonin myslimanët. Shumica e shteteve myslimane harxhuan më shumë energji në thurjen e intrigave e komplotëve kundër njëratjetrës sesa që bënë kundër pushtuesve të krishterë. Kjo duket se ka trembur disa banorë të Damaskut, Alepit, Mosulit apo Kajros. Megjithatë thirrjet e rastit për luftë kundër të pafeve nuk ishin të padëgjuesha, polemistët e mëvonshëm – për hir të tregimit të muskujve për perspektivën e përplasjes së civilizimeve – i kanë gërmuar këto dhe i kanë theksuar nga të gjitha proporcionet e frekuencës së tyre. Thirrjet myslimane për luftë të shenjtë në shekullin XII ishin të ngjashme me thirrjet për t’i dhënë fund varfërisë në shekullin XX – askush nuk mund të mos pajtohet me ambiciet fisnike, por disa ishin të interesuar në të vërtetë që të mos bënin asgjë.

Në fakt, myslimanët që ishin nën sundimin e krishterë, në vend që t’u rezistonin pushtuesve të rinj, filluan t’i rivalizonin ata. Sikur që

shumica e të krishterëve në Andaluzi mësuan arabishten dhe u përpoqën të magjepsin veten me klasën sunduese myslimane, myslimanët e shteteve të krishtera bënë atë që mundën për të fituar favorizimin e zotërinjve të rinj. Disa gjetën se sundimtarët e krishterë ishin më të drejtë sesa myslimanët që i kishin zëvendësuar. Në një refren të mrekullueshëm sikur ai i martirëve të Kordobës të shekullit IX, të cilët u dëshpëruan kur panë të krishterët që po pranonin kulturën e krishterë, kronisti Ibn Xhubejr u ankua se fshatarët myslimanë preferonin pronarët e krishterë të tokave. “Zemrat e tyre janë ngashënjyer... Kjo është një nga fatkeqësitë që ka pikëlluar myslimanët. Komuniteti mysliman vajton padrejtësinë e pronarëve të tokave të besimit të tyre, dhe miraton sjelljen e kundërshtarit dhe armikut të tij, pronarëve frankë të tokave, dhe është mësuar me drejtësinë e tij”. Dhe nuk ishin vetëm myslimanët nën sundimin e krishterë, ata të cilët pranonin bashkëjetesën. Sulltanët lokalë nënshkruan marrëveshje dhe krijuan aleanca frutdhënëse tregtare me shtetet kryqëtare. Sipas kronistit Ibn al-Kalanisi, guvernatori mysliman i Askalanit dërgoi emisarë te mbreti Baldwin i Jerusalemit për të bërë një marrëveshje, pasi “ai ishte më i dëshirueshëm për tregti sesa luftë, dhe anonte nga marrëdhënia paqësore e miqësore, dhe ofrimin e sigurisë për udhëtarët”.¹⁴

Është e vërtetë se shumica e njerëzve, shumicën e kohës, ndjekin rrugën e rezistencës më të pakët. Të përballur me një rend të ri politik, njerëzit ishin më të prirë për t’u adaptuar sesa rezistuar. Kjo ishte e vërtetë për të krishterët në Spanjën e sunduar nga myslimanët, dhe kjo ishte e vërtetë për myslimanët në shtetet kryqëtare të shekullit XII, të sunduar nga të krishterët. Deri së fundi, shumica e studiuesve supozonin se disa frankë dhe italianë, të cilët kishin imigruar në Lindjen e Afërt, jetonin vetëm në qytetet bregdetare, në Jerusalem apo Edessa, apo në kështjella të fortifikuara që vijëzonin korridorin veri-jug nga

¹⁴ Citimi i parë, rreth tolerancës religjioze franke, është nga Imad al-Din është cituar në Benjamin Kedar, “The Subjected Muslims of Frankish Levant”, në James M. Powell, ed., *Muslims Under Latin Rule, 1100-1300* (Princeton, N.J.: Princeton University Press, 1990), 161. I dyti, nga Ibn Jubayr, është cituar në Kedar, 167. Ibn al-Qalanisi është cituar në Hillenbrand, 396.

Krak des Chevaliers, midis Bejrutit dhe Damaskut, në Kerak, në jug të Amanit të sotëm në Jordani. Pjesërisht, këto supozime u bazuan në mungesën e regjistrave që listonin pronarët e tokave, por ato ishin nxitur gjithashtu nga besimi i vjetër se kryqtarët kurrë nuk do të vendoseshin në mes të një popullsie rurale armiqësore dhe të huaj. Por ata e bënë, dhe popullsia lokale i strehoi ata.

Derisa shumica e perëndimorëve u vendosën në qytete, të tjerët ngritën prona rurale të krahasueshme me ato që mund të gjendeshin në Francë apo në Luginën Rhine. Për këto prona kujdeseshin fshatarët e krishterë dhe myslimanë, besimi i veçantë i të cilëve kishte më pak rëndësi për zotërinjtë e tyre sesa aftësia e tyre për t'u kujdesur për të korrat, kullotat dhe bizneset tjera bujqësore. Për pjesën më të mirë të shekullit, sundimi i krishterë mbi këta fshatarë gjeneroi jo më shumë, megjithëse ndoshta jo më pak, tension dhe armiqësi sesa ajo që mund të gjendej në Evropën Perëndimore feudale në atë kohë. Fshatarët nuk duronin zotërinjtë e tyre; baronët përbuznin fshatarësinë. Njerëzit bënin thashetheme, nganjëherë ëndërronin për një botë ndryshe, dhe gati kurrë nuk bënë asgjë për këtë. Një gjë që të gjithë – klasë e lartë dhe e ulët, të krishterë, hebrenj apo myslimanë – e urrenin ishte kaosi. Padrejtësia ishte mezi e dëshirueshme, por ishte më e preferuar se revolucioni. Në botën e shteteve kryqëtare, ajo që kishte më shumë rëndësi ishte klasa dhe statusi ekonomik, jo religjioni.¹⁵

Megjithëse ka disa histori që kanë mbijetuar për marrëdhëniet midis perëndimorëve dhe myslimanëve, një aristokrat mysliman ka lënë një memorie të gjallë të jetës dhe kohës së tij. Usama ibn Munkidh është rritur në qytetin Shejzar në veri të Sirisë. Ai ishte, sipas fjalëve të përkthyesit dhe studiuesit Filip Hitti, “një luftëtar, gjuetar, xhentëlmën, poet dhe njeri i letrave. Jeta e tij ishte mishërim i civilizimit arab, ashtu siç lulëzoi gjatë periudhës së hershme të kryqëzatave”. Si i ri, Usama mori edukimin tipik të një aristokrati elegant urban dhe mësoi poezinë klasike, gramatikën, kaligrafinë, dhe natyrisht, Kur’-

anin. Si adoleshent, ai u mor me retorikë, filozofi, misticizëm dhe artet e luftës, por në fund, pati një mendim fatalist se Zoti ka përcaktuar të gjitha momentet e jetëve dhe gjithçka që mund të bëjë njeriu është të jetojë ditët e tij të caktuara. Nga fundi i jetës së tij, pasi që i gjithë rajoni ishte unifikuar nën udhëheqjen e kurdit Salahudin, Usama u ul dhe shkroi memoriet e tij.

Usama admironte kushtet njerëzore dhe pëlqente absurditetin e ekzistencës njerëzore. Ai shkroi tregimin e njeriut të quajtur Ali Abd ibn Abi al-Rejda, i cili u bë i njohur si ushtar dhe si grabitës që sulmonte karvanët. Ai i shërbeu një princi mysliman lokal, i cili u vra, dhe pastaj u mor në punë nga një fisnik frank. Me njohurinë e tij për rajonin dhe eksperiencën e tij në zënie e rrugëve karvanëve myslimane, Aliu ndihmoi zotërinë e tij të ri të krishterë që të bëhej i pasur në krahë të tregtarëve lokalë myslimanë. Kjo jo vetëm që nuk kënaqi ish-shokët e tij, por ofendoi thellë gruan e tij. Një natë, ajo fshehu vëllanë e saj në shtëpi, dhe kur burri i saj u kthye, ata i sulmuan dhe e vranë atë. Ajo pohoi se ishte “e zemëruar në emër të myslimanëve, për shkak të asaj që ky i pafe bëri kundër tyre”. Por, ajo i mori të gjitha gjërat e burrit të saj të vdekur dhe u zhvendos në qytetin Shejzar, ku Usama jetoi. Ajo tregoi se ishte trajtuar me respekt të madh nga fqinjët. Në një histori tjetër, Usama tregoi për një vajzë franke të zënë rob gjatë një beteje, në të cilën humbi syrin një emir mysliman. Ajo i lindi një djalë, i cili u bë princ pas vdekjes së të atit. Në vend se të jetonte në luks si nënë e nderuar, megjithatë, ajo la kështjellën dhe u martua me një këpucëtar frank.

Usama ishte fascinuar me frankët. Sikur me bizantinët, ai ishte me radhë i mahnitur dhe i tmerruar se sa të vrazhdë mund të ishin. “Misterioze janë veprat e Krijuesit, autorit të të gjitha gjërave”, shkroi ai. “Kur dikush vjen t’ju rrëfej rastet lidhur me frankët, ai nuk mundet vetëm se të lavdërojë Allahun dhe ta shenjtërojë Atë, pasi i sheh ata si kafshë që posedojnë virtyte të guximit dhe luftimit, por asgjë tjetër; vetëm si kafshë që kanë vetëm virtyte të kurajës dhe luftimit”. Usama ishte veçanërisht i habitur me praktikën mjekësore të frankëve, të cilat ishin rudimentare sa që ishin të drejtuara për të vranë pacientin. Ai

¹⁵ Shih Ronnie Ellenblum, *Frankish Settlement in the Latin Kingdom of Jerusalem* (Cambridge: Cambridge University Press, 1998).

shkroi për një mjek të krishterë lindor, i cili shëroi një kalorës frank me një lunge në këmbën e tij dhe shpëtoi një grua që vuante nga një shqetësim misterioz. Mjeku vuri llapë në këmbë, e cila absorboi infeksionin, dhe e ndryshoi dietën e gruas derisa tregoi shenja të shëndetit të gjallëruar. Frankët, megjithatë, nuk u besonin ilaçeve dhe dërguan mjekët e tyre, të cilët i përqeshnin të gjitha trajtimet. Mjeku frank refuzoi të besonte se këmba e kalorësit po bëhej më mirë, dhe i tha atij, “Çka preferon më shumë, të jetosh me një këmbë apo të vdesësh me dy?” I përballur me këtë zgjidhje, kalorësi tha se më shumë do të dëshironte të kishte një këmbë se të vdiste. Kështu, mjeku kërkoi një sëpatë dhe disa burra të fuqishëm që e mbanin kalorësin, derisa një tjetër i priste këmbën. Goditja nuk ishte e saktë. Ajo preu kockën dhe arterien e pacientit, dhe me shpejtësi ia nisi gjakderdhja për vdekje. Ndërsa për gruan, mjeku frank ia hodhi një shikim dhe deklaroi se ajo ishte e pushtuar nga djalli. Ia rroi kokën, nuk e ushqeui përveçse me hudhër dhe mustardë, e shikoi derisa po bëhej më e dobët, ia skaliti një kryq në kafkë, lëkura iu zhvish, ia hodhi kripën në kockën e ekspozuar, largoi demonin, dhe vrau pacientin.

Për të qenë i paanshëm, Usama përshkroi edhe shembuj kur mjekësia franke pati sukses në shërimin e pacientëve me trajtime të panjohura në Siri në atë kohë, si një sajesë prej hirit, uthullës, plumbit të djegur dhe gjalpët të pastruar që përdorej si një balsam për plagën në qafë. Por në përgjithësi, ai ishte i tmerruar dhe i habitur nga injoranca e madhe e frankëve.

